



Drita e Kur'anit



FLETUSHKË E SHOQATËS SË NXËNËSVE TË MEDRESE SË MESME "ALAUDDIN" NË PRISHTINË
1967

Althe



Gej' Xhuzi (30) Amme



إن الحمد لله نحمده ونستعينه ونستغفره ونعوذ بالله من شرور أنفسنا ومن سيئات أعمالنا من يهده الله فلا مضل له ومن يضلله فلا هادي له وأشهد أن لا إله إلا الله وحده لا شريك له وأشهد أن محمداً عبده ورسوله. أما بعد:

فلا هادي له وأشهد أن لا إله إلا الله وحده لا شريك له وأشهد أن محمداً عبده ورسوله. أما بعد:

Fjala e redaksisë

Njeriu duke u ngritur mbi interesat individuale, pas imperativit kur'anor: "Mos u bëni sikur ata që u ndanë e u përganë, pasi u patën xbritur argumente" do të ngritet në shkallën më të lartë të dashurisë e të vëllakërisë ndërnjerëzore, duke larguar njëherë e përgjithmonë urrejtjen, përganjen dhe koprracinë nga zemra, sepse drita e imanit (besimit) gjën dhe kë vend vetëm në ato zemra të pastërta dhe pa komplekse.

Në botën që po jetojmë shumë nga njerëzit humbën rrugën e drejtë nëpër errësirën e mosdijes. Humbën kërën e arsyes dhe dështuan. Si rezultat i këtij dështimi ishin ideologjitë dhe sistemet që sapo lindnin, aq edhe më shpejtë perëndonin. Ishin afatshkurtyera ngase bazamenti i tyre ishte errësirë.

Krahua tyre, nëpër shekuj e mote, "Drita e Islamit" kurrë nuk u xbeh e as nuk u venit. Përkundrazi, shkëlqimi i saj ndriçotne rrugët e shtegtit njerëzor, mbushte zemrat e besimtarëve me shpresë dhe besim, përherë duke prirë si një flakadan i dritës Hyjnore.

Duke qenë të vetëdijshëm se jemi nën hyjën e kësaj drite dhe duke pasur përherë në konsideratë emigratin dhe përgjegjësinë që kemi, u përpoqëm që sadopak nëpërmjet fletushkës "Drita e Kur'anit" të reflektojmë këtë dritë edhe tek ju.

Je mbështetur me tërë qenien tonë në Zotin e Fugjplotë, shpresojmë se rrezet e "Dritës së Kur'anit" do të jenë udhëim për çdo zemër që do të udhëkohet ngase i Gjithëfuqishmi thotë:

Kush i përmbahet udhëimit Tim, ai nuk do të humb (në këtë jetë), e as nuk do të dështojë (në jetën tjetër), e kush ia kthen shpinën udhëimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e Kijametit do të ringjallim të verbër.

All-llahu na ndihmoftë në përpjekjet tona fisnike

Adnan Simnica

Botues:	
Shoqata e nxënësve të Medresës së Mesme	
"Alauddin" Prishtinë	
Kryeredaktor: Adnan Simnica	
Këshilli redaktues:	
Bajrush Ahmeti, Rustem Spahiu, Jusuf Gashi, Ahmet Rama,	
Emin Dërguti, Jakup Çunaku, Adem Breznica, Florim Gruda,	
Adnan Sogojeva, Afrim Isufi dhe Agron Tërziqi	
Lektor dhe korrektor: Jusuf Gashi	
Përpunimi kompjuterik: shuli	
Fletushka del sipas mundësis	
Adresa: Redaksia e "Nurit" f.p. 89. Prishtinë	
Tel. 038/ 32-472 & 32-473	
Është lejuar botimi i fletushkës "NUR-UL-KUR'AN" me vendim	
min e Sekretariatit për informata të Kuvendit të Kosovës dhe	
Këshillit Ekzekutiv nr. 01-650-64 të dt. 18.3.19973 në Prishtinë	
Dorëshkrimet nuk kthehen	

Përmbajtja	
Mirë se na erdhe, o muaj i bekuar	3
Ramazani muaj i shpëtimit	4
Zekati dhe Sadakatul-Fitri	6
Jomuslimanët për Muhamedin a.s. dhe fenë Islame	7
Mëkatet shkatërruese	8
Dashuria ndaj Allahut xh.sh.	10
Personaliteti i Muhamedit a.s.	12
Lëvizjet shkatërruese në historinë islame	14
Definimi i synetit dhe bidatit	15
Mënyra e stesës në islam	16
Si e përqafova Islamin	18
Argumentet shkencore të shpalljes së Kur'anit	20
E vërteta për dukurinë e quajtur "gravitet"	22
Vlerën që ia dha njeriut Allahut xh.sh.	25
Kush ishte Abdullah iben Mesudi	26
Mëshira e Allahut xh.sh.	27
O ihtarë të librit ejani të bashkohemi	28

Mirë se na erdhe, o muaj i bekuar

Fetihor

- Mirë se na erdhe o muaj i mëshirës, i faljes dhe i shpëtimit. Mirë se na erdhe o muaj i dritës, i solidaritetit dhe devotshmërisë ku shpirtrat e besimtarëve gjejnë prehje të sigurt.

Muaj i bekuar je ti, sepse për ty ka thënë Allahu xh.sh.:

"Muaji Ramazan është ai në të cilin filloi të shpallet Kur'anë, udhëzimi për njerëzit dhe argument i qartë i rrugës së drejtë".

Në këtë muaj të gjithë muslimanët e madhërojnë Allahun dhe e respektojnë duke agjëruar, duke u falur, duke lexuar Kur'anin etj. Gjithashtu është muaj në të cilin ndriçohet rruga e drejtë dhe e qartë, drejt Allahut xh.sh.

Ky muaj le të jetë muaj i solidaritetit dhe humanitetit në mes të muslimanëve. Le të jetë bashkëpunim i ndërsjellë në mes të pasurëve dhe të varfërve sepse nëpërmes agjërit kuptohen seriozisht vuajtjet e atyre që kanë vështirësi dhe probleme sociale në jetën e përditshme. Agjërimi islam është shumë i përsosur dhe

i logjikshëm dhe duke u mbështetur në këtë i bëjmë thirrje rinisë "Të mos lihet anash agjërimi, namazi, solidariteti, etj", sepse ato janë mburojë dhe shpëtim për ne.

Nëpërmes tyre arrihet shkalla më e lartë e dashurisë dhe vëllazërisë gjithislame-shqiptare. Ky muaj le të jetë muaj i bashkimit për të gjithë muslimanët dhe muaj i aplikimit të "Sheriatit" në çdo vend islam. Besojmë se fletushka jonë përmban tema moralo-edukative të cilat do të ndikojnë drejtëpërdrejtë në pasurimin shpirtëror të rinisë islame.

Prandaj edhe ne nëpërmes kësaj fletushke të gjithë besimtarëve islam ua urojmë për shumë vjet muajin e bekuar të Ramazanit, duke e lutur të Gjithëfuqishmin që të gjithë muslimanët kudo që gjinden t'i forcojë në rrugën e drejtë dhe të largojë nga mesi i tyre urrejtjen dhe fanatizmin të cilët janë të përgatitura nga armiq të islamit.

Redaksia

Namazi

*Për detyrë e ka,
çdo i vjetër dhe i ri
që namazin ta falë
në shtëpi apo xhami*

*Nëse njeriu do
që Zotin ta ndjejë afër
duhet të falë namazin
dhe të jetë i pastër.*

*Kur falim namazin
çdo breng harrohet,
në atë çast njeriu
All-llahut i dorëzohet.*

*Nëse një njeri
kalon kohën së koti,
në Ditën e Gjykimit,
do të dënohet nga Zoti.*

Izet Gashi IV.a

Ramazani muaj i shpëtimit

- Zoti xh.sh. në suren El-Bekare thotë:

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikur që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm".

Në këtë ajet dëshmon Zoti xh.sh. se agjërimi ka qenë obligim edhe për popujt tjerë që ishin më parë (d.m.th. agjërimi nuk qenka obligim vetëm për ymmetin e Muhamedit a.s., por paska qenë obligim edhe për ymmetet tjera, gjegjësisht popujve të pejgamberëve të tjerë).

Në këtë ajet dhe në dy ajetet që vijnë pas tij tregohet se agjërimi nuk është paraparë në të njëjtën formë siç është paraparë për muslimanët dhe besimtarët e mëparshëm. Feja islame e ka ngritur lart dhe e ka shpirtualizuar këtë institucion duke e vënë nën rregullat të shumta, e që janë shumë të logjikshme dhe të frytshme. Në tri ajetet e lartpërmendura të Kur'anit tregohet se qëllimi kryesor i agjëritimit është që së pari njeriu të sigurohet nga vuajtjet dhe së dyti të qëndrojë larg të keqes dhe mëkatit. Agjërimi, jo vetëm që mirëmban balansin e rregullimit fizik të trupit dhe vënien e njeriut në pozitë që të përballojë vështirësitë, por ai bën që njeriu të shprehë simpati dhe solidaritet me ata të cilët janë në fatkeqësi dhe tragjedi të jetës dhe me ata të cilët janë të varfër.

Largimi i njeriut nga veprat e këqija dhe të liga bëhet me anë të agjëritimit, ashtu që njeriu duke agjëruar, jo vetëm që përmbahet nga të ngrënit dhe të pirat, por qëndron edhe larg disa gjërave dhe dëshirave të epshit të tij. Pra me anë të agjëritimit arrihet përsosja shpirtërore e cila është esenciale për njeriun. Në ajetet e sipërpërmendura tregohet se nuk duhet agjëruar në të gjitha rastet. Urdhëri përjashton të sëmurët dhe udhëtarët. Pra islami është religjion praktik dhe shpirtëror i cili nuk jep urdhër që nuk mund të zbatohet.

Muaji i devotshmërisë dhe i largimit nga të këqiat

- Muslimani është i bindur në urdhërin e Zotit xh.sh. për agjërim apo për çdo ibadet tjetër është e vetmja rrugë për të mirën e njeriut si në pikëpamje trupore ashtu edhe në atë shpirtërore dhe me anë të tij arrihet devotshmëria dhe shprehi e "takvallëkut", siç shprehet edhe vetë Allahu në

librin e tij fisnik: "(Agjërimi u është bërë obligim), që të bëheni të devotshëm". Dihet fare mirë se agjërimi dhe mënyra më e mirë për largimin nga veprat e këqija dhe ndikon drejtpërdrejtë në pastrimin shpirtëror. Mbi domethënien e fjalës et-takva, Omeri r.a. e ka pyetur Ka'bin që t'ia shpjegonte kuptimin e kësaj fjale, e ai i tha: a ke ecur ndonjëherë në ndonjë rrugë të mbushur me therra? Omeri iu përgjigj, po. Çka bëre ti atëherë, e pyeti ai. Omeri iu përgjigj "Eca me kujdes duke u ruajtur shumë", atëherë Ka'bi i tha: - Ajo është domethënia e fjalës takva, të ruhesh nga të këqijat dhe të kujdesesh që mos të biesh në to.

Muslimani pra agjëron sepse Zoti e ka urdhëruar dhe e kryen në shenjë respekti ndaj urdhërit të tij. Nuk duhet shkuar nga ajo se agjërimi apo ndonjë ibadet tjetër ka këtë apo atë të mirë shëndetsore, sepse atëherë agjërimi kryhet për hirë të asaj të mire, e jo për hirë të urdhërit të Zotit xh.sh.. Një ibadet i tillë nuk meriton shpërblim nga Allahu. Agjërimi duhet të jetë mjet nëpërmes të cilit fitohet devotshmëria, e të mos bëhemi prj atyre që nuk i përgjigjen urdhërit shumë të arsyeshëm dhe të logjikshëm, të Zotit.

Agjërimi të jetë muaj i pastrimit nga mëkatet dhe muaj i largimit nga të këqijat dhe të irituarat. Thotë Allahu xh.sh.:

"Do të shpëtoj ai i cili pastrohet" (El-Ala 14).

Duke u arsyetuar në atë se agjërimi sikurse edhe namazi i kryer me sinqeritet, është mjeti më i mirë dhe më efikas për pastrimin e shpirtit.

Muaji i faljes dhe pranimit të lutjeve

Muhammedi a.s. thotë: Kur të vijë muaji i Ramazanit hapen dyert e xheneteve dhe mbyllen dyert e xhehenne-meve dhe thirret nga ana e Allahut xh.sh.: O kërkues i mirësisë, urdhëro, dhe o dëshirues i së keqes, ik!. "Pastaj hadithi tjetër ku thotë: "Sikur ta dinin robërit se çfarë vlefte ka Ramazani, do të dëshironin ymeti im që tërë viti të ishte Ramazan".

Muslimani i cili agjëron e ndien nderimin e zotit, begatitë e Tij, e ndriqon zemrën e tij kah Zoti, duke e dashur, falënderuar dhe harmonizuar veprat e tij me urdhërat e Zotit, i tillë doemos do të jetë i falur prej mëkateve.

Gjithashtu Allahu xh.sh. është shumë afër agjëruësve ku edhe thotë:

"Dhe kur të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet".

(El-Bekare 186).

Ky ajet jep të kuptojë, afërsinë e agjëruesit me Zotin xh.sh. si dhe pranimin e lutjes së tij të Allahu. Sa i mrekullueshëm është ky ajet i Kur'anit dhe sa kuptimin e thellë që e ka, aty gjejmë përgjigje direkte sepse Zoti nuk ka thënë: thuaju atyre, Unë jam afër, por nixtoi e tha: "I përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet". Këtu drejtëpërdrejtë shihet mëshira e Allahut që ka ndaj robërve të vet të dashur.

Ndërsa Muhammedi a.s. thotë:

"Vërtet Allahut të Madhëruar i vjen keq që rob i Tij t'i ngritë duart dhe të kërkojë prej Tij ndonjë të mirë e ta kthejë atë të dëshpëruar". Mirëpo pasi që ky muaj quhet muaji i faljes dhe i pranimit të duave, lutja e singertë sigurisht do të pranohet. Lidhur me këtë thotë pejgamberi a.s. "Agjëruesit në iftarin e tij, lutja i pranohet dhe thuhet: Vërtet agjëruesit në iftarin e tij, lutja nuk i kthehet".

Agjërimi është mburojë prej zjarrit

Muhammedi a.s. transmeton hadithin kudsij ku thuhet:

"Vërtet agjërimi është mburojë prej zjarrit, nëse dikush prej jush është agjërueshëm, mos të flasë, e nëse dikush e ngacmon atë apo e shanë atë". Le të thotë: unë jam agjërueshëm.

Në këtë hadith Pejgamberi a.s. shpjegon se si duhet të veprojë besimtari që agjërimi të jetë mburojë prej zjarrit (në ditën e gjykimit) dhe shmangie nga të shëmtuarat.

Por si të jetë mburojë?

A thua çfarë agjërimi është ai kur njeriu përgojon njerëzit tjerë, i hap veshët që të dëgjojë atë që nuk duhet, i hap sytë që të shiqojë gjërat të ndalaura e fytyra të bukura, ose ai i cili tërë ditën flet ose rri në shtëpi duke mos falur namazin dhe pas iftarit del dhe tërë natën e kalon në vende të ndyta. A thua agjërimi për këta njerëz është mburojë?

Përgjegja është se për këta njerëz nuk është mburojë, sepse thotë Pejgamberi a.s. "Në qoftë se personi që agjëron nuk largohet nga fjalët dhe veprat e liga, Zoti xh.sh. nuk ka nevojë për ndalimin e tij nga haja dhe pija", si dhe hadithi tjetër që thotë: "O sa agjërues ka, që nga agjërimi i tyre nuk kanë asgjë tjetër përveç urisë dhe etjes", e që është një argument për ata të cilët bëjnë kesi lloj agjërimi duke iu treguar se nuk ka shpërblim te Allahu dhe se agjërimi i këtillë nuk e ka efektin që e parasheh Zoti.

Në të gjindet Nata e Kadrit

Vlera tjetër e Ramazanit është edhe ajo se në të gjendet nata e Kadrit për të cilën ka thënë Zoti xh.sh. "Nata e Kadrit ka vlerën më shumë se një mijë muaj". Këtu në mënyrë direkte tregohet rëndësia e kësaj nate. Ndërsa Muhammedi a.s. ligjëroi në ditën e fundit të muajit Shaban dhe tha: "O ju njerëz, është afëruar muaji famëlartë dhe i begatshëm në të cilin gjindet nata, që vlerësohet më tepër se një mijë muaj, në të cilin muaj obligohen agjërimi dhe namazi vullnetar, kush vepron pak, fiton shumë, ai që kryen një farz në të sikur ka kryer shtatëdhjetë farze në një kohë tjetër, ky është muaji i durimit, kurse durimi shpërblehet me xhennet, ky është muaji i barazisë dhe i shtimit të furnizimit, të lumiturisë..".

Për agjëruesin do të ketë shpërblim të posaçëm

Agjërimi veçohet nga ibadetet tjera sepse ai nuk shihet sikur edhe obligimet tjera. Ai është sekret në mes robit dhe Krijuesit, andaj për këtë thuhet në hadithin kudsij:

"Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit, ai me të vërtetë është për Mua dhe Unë shpërblej për të".

Disa hadithe mbi agjërimin

- Besimtari në agjërim përjeton dy kënaqësi: një në iftarin e tij dhe tjetrin kur të takohet me Zotin xh.sh. në Ditën e Gjykimit. (h. Kudsij).

- Xhelozia i shkatërron veprat e mira sikur zjarri që i shkatërron drunjtë, kurse sadakaja i shkatërron mëkatet, sikurse uji që e fik zjarrin. Namazi për besimtarin është dritë, kurse agjërimi është mburojë nga zjarri.

- Në muajin e Ramazanit ymmetit tim i janë dhënë pesë gjëra, që nuk i janë dhënë ndonjë pejgamberit tjetër (para meje) ato janë:

1) Kur vjen nata e parë e Ramazanit Zoti xh.sh. i shiqon me shqim të Vet dhe nuk e dënon atë (Ymmetin).

2) Melaiket luten për faljen e tij ditë e natë.

3) Allahu xh.sh. e urdhëron xhennetin dhe i thotë "Zbukurohu për robin tim agjërues, sepse do të pushojnë nga lodhja e kësaj bote (e të pushojë) në shtëpinë time.

4) Me të vërtetë aroma e gotave të tyre kur të bëjnë iftar është më e këndshme se aroma e miskut.

5) Kur vjen nata e fundit Allahu xh.sh. i fal të gjithë, ngase punëtorët punojnë dhe kur ndahen nga puna (kur e kryejnë punën), marrin shpërblimin e tyre.

Adnan Simnica

kl. IV-a

Zekati dhe Sadakatul - Fitri

Islami që bazohet në Kur'an dhe hadith, si të vetmet burime të së drejtës islame, brenda kufijve të së cilës duhet të zhvillohet jeta publike dhe private e çdo muslimani, nuk ndalet vetëm në besim dhe në ritualin fetar, por hyn thellë në çështje ekonomike.

Zekati është institucionalizuar drejtëpërdrejtë me Kur'an dhe hadith, është ndër urdhërat më me rëndësi të Zotit xh.sh. (farz) dhe si i tillë përmendet në Kur'an në më se 30 vende krahas me namazin. Në Kur'an thuhet: *"Faleni namazin dhe jepni zekatin"*.

Përpos në Kur'an zekati është përmendur bashkë me namazin në shumë vende edhe në hadith. Në një hadith është theksuar se: *"Namazi është shtylla kryesore e fesë, kurse zekati është ura e islamit"*.

Zekat quhet një sasi e caktuar e pasurisë të cilën muslimani, pas urdhërit të Zotit, e jep në dobi të personit tjetër musliman. Nëse besimi është detyrë shpirtërore: namazi, agjërimi dhe haxhi detyra trupore, dhënia e zekatit është detyrë në pasuri. Juristët e quajnë "ibadet malije" (adhurim me pasuri). Kur'ani e përdor me disa termine si:

- Zekat. d.t.th. rritje dhe pastrim, që do të thotë se duhet dhënë një pjesë të të ardhurave që t'i rrisim dhe pastrojmë

- Sadaka, e cila do të thotë dashuri ndaj të vërtetës dhe dhembshuri, e kjo është: ta argumentojmë të vërtetën e mëshirës sonë, lypset dhënë sadaka.

- Hak, - e drejtë, nëse ajo është e drejtë e tjetrit atëherë detyrë e atij që posedon.

Në këtë mënyrë janë tatimuar kursimet, korrjet, tregtia, bagëtia që kullosin nëpër fusha, xehet, prodhimet e detit...

A thua nuk është ajeti plotësisht i qartë dhe kategorik në këtë pikëpamje: *"Bëmirësi nuk është t'i ktheni fytyrën lindjes ose perëndimit por bëmirësi bën ai që i beson Allahut, ditës së gjykimit, melaikeve, librave dhe profetëve, ai që pasurinë të cilën e do dhe mallin e nevojshëm ua ndan të afërmeve të vet, bonjakëve, nevojtarëve, udhëtarit, të varfërit, lypësit dhe skllavit që të lirohet, ai që fal namazin, që e jep zekatin, e plotëson atë që premtion, duron kur t'i bien në shpinë hallet e vështirësitë. Ata janë të singertë dhe i frikësohen Zotit"*.

(El Bekare: 177)

Thuhet se Muhammedi a.s. duke e shpjeguar rëndësinë, domethënien dhe nevojën e domosdoshme të solidaritetit shoqëror dhe arsyeshmërinë e zekatit, ka thënë: *"Në kapital*

ka obligim përpos zekatit". E pastaj e ka theksuar ajetin e përmendur më parë, që na tregoni se detyrimet materiale sikundër edhe detyrimet tjera janë shumë më të gjëra dhe shtrihen në të gjitha fushat e aktivitetit njerëzor.

Sahabët dhe ulemaja kanë folur mjaft për këtë. Pas vdekjes së Pejgamberit a.s. në kohën e halifit Ebu Bekrit. disa fise arabe nuk pranuan të japin zekat. Ebu Bekri vendosi të dërgojë ushtrinë kundër tyre. Omeri nuk u pajtua me këtë. I tha Ebu Bekrit: *"A do të luftosh kundër njerëzve kurse i dërguari i Zotit ka thënë: "Më është udhëruar t'i lftojë njerëzit derisa të thonë dhe të pranojnë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut. Kur të pranojnë këtë, do t'u garantohet siguria e pasurisë dhe e jetës së tyre, përpos nëse bëjnë diç tjetër që e meriton dënimin"*. Pas këtyre fjalëve Ebu Bekri tha: *"Pasha Allahun, do të luftoj kundër cilitdo që bën dallim midis namazit dhe zekatit. Betohem në të gjithëfuqishmin se, sikur të ma mungonin vetëm një grimcë që e kanë dhënë në kohën e Pejgamberit a.s. unë do t'u shpall luftë"*. Pastaj Omeri tha: *"E ai kishte të drejtë. Vendimi i tij ishte me vend"*.

Abdullah b. Mesudi ka thënë: *"U është urdhëruar ta falni namazin dhe ta jepni zekatin. Kush nga ju e fsheh zekatin, ai nuk ka kurrfarë dobie nga namazi"*. Në lidhje me këtë çështje gjykimin e vet e ka dhënë edhe ibn Zejdi: *"Namazi dhe zekati janë detyrë të prera fetare. Nuk ka kurrfarë ndryshimi midis tyre"*. Pas këtyre fjalëve, të pranishëmve ua lexoi ajetin e Kur'anit:

"Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë ata i keni vëllezër për nga feja"

(Et - tevbe 11).

Në fund e shtoi edhe këtë: *"Pasha Allahun, do të luftoj kundër kujt do që bën dallim ndërmjet namazit dhe zekatit"*.

- **ZEKATUL-FITRI**: - Të njejtin kuptim e ka edhe zekatul fitri i njohur si sadakatul - fitr ose VITRA. Dallimet themelore në mes zekatit dhe zekatul - fitrit janë:

1. Zekati jepet për kapital - zekatul - fitri për persona.
2. Zekati mund të jepet gjatë tërë vitit, e zekatul - fitri vetëm gjatë ramazanit, dhe si i tillë konsiderohet, vetëm në qoftë se është dhënë para se të falet namazi i bajramit, në të kundërtën është lëmoshë e thjeshtë.

Sipas madhhebit tonë hanefij zekati pamë se është farz e sadakatul-fitri vaxhib.

Zekatul-fitri si detyrim, është përcaktuar me rastin e përfundimit të agjërimit të ramazanit dhe ardhjes së festës

së bajramit, në shenjë falënderimi Allahut xh.sh. për bekimin e agjërimit, për bekimin e gëzimit për festën e përmendur dhe bekimin e ndihmës që i jepet atij që ka nevojë. Duke pasur parasysh këto tri bekime është caktuar koha për të, kur duhet të jepet.

Secili musliman që posedon vlerën e një "saa" grurë ose elb, hurma ose diç të ngjashme me këto që i tejkalon nevojat themelore për tërë ditën dhe natën e parë të festës është i obliguar të japë zekatul-fitrin, për vete dhe për secilin person. Në këtë pikëpamje hadithi është fare i qartë: prej Omerit r.a. thotë: "I dërguari i zotit xh.sh. e caktoi dhënien e Zekatul-fitrin në ramazan një saa hurma ose një saa elb për secilin rob ose person të lirë, mashkull ose femër. të vogël ose të madh nga radhët e muslimanëve". (buhariu, Muslimi).

Ibni Omeri r.a. thotë: "i dërguari i Zotit ka urdhëruar që zekatul-fitri të kryhet para se njerëzit të shkojnë në bajram". (Të gjithë muhaddithinët përpos ibni Maxhes).

Prej Ibni Abbasit r.a. "I dërguari i Zotit caktoi dhënien e zekatul-fitrin për pastrimin e agjëruesve nga fjalët e të papunëve dhe nga fjalët e pahijshme si dhe për ushqimin e të nevojshëmve. E kush e kryen këtë obligim para bajram-namazit i pranohet si zekat, e kush e kryen pastaj i pranohet si sadaka" (Ebu Davudi, ibnu Maxhe dhe Hakimi).

Përfundojmë se kemi detyrë ta kryejmë këtë dhe të bëjmë centralizimin e zekatit dhe të zekatul-fitrin, të cilët i mundësojnë Bashkësisë Islame ndërmarrje të reja, si dhe normalizimin e rrethanave në insitucionet ton islamike arsimore, punën e plotësisht normale në Medrese dhe në Fakultetin e Studimeve Islame.

Burhan Hoxhaj IV-b

Jo muslimanët për Muhamedin a.s. dhe fenë islame

Peti i madh rus Pushkini është shprehur për Muhamedin a.s. kështu:

Shiko, shiko larg, o Profet i Madh dhe lajmëro nga vendi në vend, duke kaluar në tokë e det për të ngritur peshë zemrat me fjalën tënde reale dhe të shenjtë të Zotit.

Geteja, si poeti më i madh i mendjes njerëzore (gjenerali i poezisë), në një rast të vlerësimit të Kur'anit ka thënë:

"Sa i lumtur do të isha sikur edhe për gjysmë ore të isha Muhamedi"

Dijetari i njohur "Shibril", dekan i fakultetit juridik në Universitetin e Vijenës në simpoziumin mbi drejtësinë në vitin 1927 ka thënë:

"Njerëzia krenohet me Muhamedin që i takon races së tyre. Edhe pse nuk dinte shkrim-lexim ka arritur sukses që para 14 shekujve, ka arritur në një ligj (shariat) të cilin në Evropianet sikur ta arrinin vlerën e tij pas 1000 viteve do të ishim më se të kënaqur.

Ogyst Konti - mendimtar francez dhe themelues i sociologjisë, ka deklaruar:

"Nëse është e domosdoshme që në kohën e sotme të kemi një fe, atëherë ajo fe nuk mund të jetë përveç feja islame.

Lin Bol, në librin e tij "Arabët në Spanjë" thotë:

Kur Evropa ka qenë në errësirën e injorancës dhe prapambeturisë, mu në atë kohë Endelusi (Spanja) ishte udhëheqëse në dituri dhe simbol i kulturës në botë.

Filozofi anglez Bernard Shaw thotë:

"Feja e cila iu shpall Muhamedit posedon terheqshmëri të posaçme pasi që ajo ka gjallërinë e përhershme, ajo është feja e vetme e cila i plotëson nevojat e kohës, pra jam i mendimit dhe e shoh të nevojshme që Muhamedi të shpallet shpëtimtar i njerëzimit, po sikur udhëheqësia e botës moderne t'i besonet një njeriu si Muhamedi, do të zgjidhte të gjitha problemet e kohës".

Dr. Asiko Nesabato, thotë:

"Sheriati islam ua ka tejkaluar në lëmi ligjeve evropiane, ai është ligj më i sigurt dhe më stabil".

e përgatiti:

Salih Beqiri KIV-a

Mëkatet shkatërruese

Bazuar në Ebu Hurejren se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:
"Largohuni shtatë gjërave shkatërruese. (Shokët) i thanë:
O i dërguar i All-llahut xh.sh. cilat janë ato?

U tha: Ato janë:

1. T'i bësh All-llahut shok (shirku)
2. Të bësh magji (sihri)
3. Mbytja e njeriut që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në baza të drejtësisë.
4. Të marrësh kamatën.
5. T'ia hash mallin bonjakut (jetimit)
6. T'ia kthesh shpinën armikut (ikja nga fronti)
7. T'i shpifësh gjëra të keqia (amoralitetet) besimtarve të pastërta.

Transmeton: Buhariu, Muslimi, Evu Davudi, dhe Nesaiu. Falenderimi është për All-llahun xh.sh që na drejtoi në fenë Islame dhe na bëri prej besimtarëve. Atë që All-llahu e udhëzon s'ka kush që e humb ndërsa atë që e humb s'ka kush që e udhëzon. Paqja dhe meshira e All-llahut qoftë mbi Muhammedin a.s. mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë muslimanët deri në ditën e gjykimit. Ky hadith bën fjalë për shtatë mëkatet e mëdha shkatërruese. I lutemi All-llahut xh.sh që të na largojë prej tyre. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:
"Nëse largoheni prej mëkatëve të mëdha, të cilat u janë ndaluar, ne ju shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm."

Nisa 31

Në hadithin e lartpërmendur Pejgamberi a.s. na urdhëroi që të largohemi nga shtatë gjëra të dëmshme, nga shtatë mëkatë të mëdha, por nuk do të thotë se vetëm këto janë mëkate të mëdha. Dijetarët kanë numëruar më shumë se shtatëdhjetë mëkatë të mëdha.

1. Mëkati i parë i përmendur në këtë hadith është shirku. Në Kur'an thuhet:

"Ai që i përshkruan Zotit xh.sh. shok All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhenetin dhe vendi i tij është zjarri".

El-maide 72

Shirk do të thotë të adhuroarit tjetër kënd në vend të All-llahut xh.sh. p.sh. të kërkuarit ndihmë nga idhujtë, lutja në ta, betimi në ta, apo të kërkuarit ndihmë nga Muhamedi a.s kërkimi ndihmë prej xhinve, ose prej të vdekurëve etj. E tërë kjo është shirk sepse në vend që t'i lutemi, të kërkojmë ndihmë, të betohemi në të plotëfuqishmin All-llah, këto i bëhen tjetër kujt. All-llahu në Kur'an thotë:

"Pasha All-llahun, ty të është shpallur dhe atyre para teje: Nëse i bën shok (All-llahut) veprat tuaja janë të asgjësuar dhe ti do të jesh prej të humburve."

Ez-Zumer 65.

2. Mëkati i dytë xh.sh. në Kur'an thotë

...(ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt para se t'i thonin: ne jemi vetëm sprovë dhe mos u bë i pa fe."

Ek-Bekare aj. 102.

Magjia është një gjë e shëmtuar e cila mbulon të vërtetën dhe luhat njerëzit nga besimi. Magjia është prej gjërave të ndaluara të cilat shpiejnë në kufer, për arsye se magjistari pohon se është njohës i çështjeve të fshehta, e që njohës i tyre është vetëm Allahu xh.sh. Për fat të keq shumë njerëz mendojnë se magjia është vetëm mëkat-haram e nuk e dinë se ai është kufër. Dënimi për magjistarin është mbytja e tij, sepse ai është i pafe. Nuk do të thotë se vetëm magjistari është kafir, por edhe ata që i besojnë atij dhe ato gjëra i konsiderojnë si të vërteta edhe ata janë të njëjtë me magjistarin. All-llahu në Kuran thotë:

"...E ata (jehudit) e kanë ditur se ai që (e hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në meshirën e Zotit xh.sh.) Po ta dinin, ata se për çka e shitën vetvetën ajo është shumë e keqe."

El-Bekare ajo. 102.

3. Mëkati i tretë mbytja e njeriut.

Allahu në Kur'an thotë: *"Edhe ata që nuk e lusin përveç All-llahut ndonjë Zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon*

këto ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi në ditën e kijametit dhe mbetet i përbuzur përgjithmonë".

Furkan aj.68-69.

Muhammedi a.s. në një hadith thotë:

"Çdo mëkat ndoshta Zoti e fal, përveç atij që vdes në mosbesim, dhe ai që mbyl besimtarin me qëllim, pa ndonjë faj" Trans...Nesaiu, Ebu Davudi etj. Mbytja e njeriut lejohet vetëm në tri raste: Ai që mbyl dike, i martuari që bënë zina dhe ai që duke qenë musliman largohet nga feja. Raste të tjera nuk ka. Allahu xh.sh. thotë:

"... Kush e mbyl një njeri (pa të drejtë), pa mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasur ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si të kishte mbytur gjithë njerëzit".

El Maide 32.

4. Mëkati i katërt është marrja e kamatës

Allahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, keni frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të sinçertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E nëse nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe me të dërguarin e tij".

ElBekare 278-279.

Allahu e ka ndaluar eksploatimin e njëri-tjetrit. Muhamedi e ka numëruar kamatën si faktor shkatërrues të shoqërisë dhe e ka mallkuar atë që merr, atë që shkruan marrëveshjen dhe dëshmitarin e atyre marrëveshjeve. Allahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, mos e hani kamatën që po e shumëfishoni dhe keni frikë (dënimin) e Allahut, ashtu që të gjeni shpëtim".

Ali Imran 130.

5. Mëkati i pestë është ngrënia e pasurisë së jetimit (bonjakut)

Thotë Allahu xh.sh.

"Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë, (mund t'i afroheni) vetëm në mënyrë më të mirë..."

El Enamë 152.

Por ka edhe njerëz të atillë të cilët janë zemërgur e të pamëshirshëm, që nuk u mjafton kur shikojnë fytyrat e bonjakëve, atë fytyra të përvuajtura, ku shihet qartë dhembshuria se kanë mbetur pa baba ose pa nënë, apo pa të dy, por edhe marrin nga pasuria e tyre. Allahu xh.sh. thotë:

"Ata që hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e xhehenemit"

En-nisa 10.

6. Mëkati i gjashtë është ikja nga lufta.

Allahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, kur të ndesheni në turmën e atyre që mohuan, mos ua ktheni shpinën".

Besimtarët urdhërohen që armikut mos t'ia kthejnë shpinën kursesi. Ai që ik prej betejës është i dënuar në të dy botërat, sepse besimtari duhet ditur që ndihma e Zotit është me të. E nëse vdes ai është shëhid. All-llahu xh.sh. thotë:

"Kush ua kthen atyre shpinën, në atë moment veç atij që kthehet për të luftuar ose për t'ua bashkangjitur një grupi tjetër, ai e ka tërhequr kundër vetes hidhërimin e All-llahut dhe vendi i tij është xhehenemi. E ai është përfundim i keq".

El Enfal 16.

7. Mëkati i shtatë është të shpifësh gjëra të këqija besimtarëve të pastërt

Thotë All-llahu xh.sh.:

"Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret dënim shumë i madh".

Nur 23.

Shpifja është një prej veseve të shëmtuara që rrënon me themel qytetërimin e një bashkësie njerëzore, andaj feja ka paraparë masa të rrepta ndëshkuese për bartësit e kësaj dukurie. Thotë All-llahu xh.sh.:

"Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrahni ata me nga 80 të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm".

Nur 4.

*Bashkim Avdiu
kl.IV/b*

Dashuria ndaj Allahut xh.sh.

Me që zemra cilësohet me jetë dhe vdekje, ajo ndahet në tri lloje:

1. Zemra e shëndoshë: ai i cili vjen në ditën e kijametit me këtë zemër shpëton. Allahu xh.sh. thotë:

"Ditën kur nuk bën dobi as malli as fëmijët, vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë".

(Esh-shuara 88-89).

Zemër e shëndoshë është zemra që cilësi të përherëshme ka shëndetin.

Ka shumë mendime për domethënien e zemrës së shëndoshë. Mirëpo të gjitha këto definime i përmbledh thënia se zemra e shëndoshë e pastër nga çdo epsh që kundërshton urdhërin e Allahut dhe ndalesën e Tij dhe është e pastër nga çdo dyshim që i kundërvihet mesazhit të Tij. Pra nuk adhuron askënd, përveç Allahut dhe nuk merr për gjykues askend përveç Pejgamberit a.s.. Kjo zemër e do Allahu, merr për gjykues Pejgamberin a.s. në çdo rast dhe në çdo çështje. Allahut i frikësohet dhe Atë e shpreson, Atij i mbështetet dhe tek Ai pendohet, përherë i jep përparësi kënaqësisë së Allahut dhe mundohet që t'i shmanget hidhërimit të Tij. Ky është adhurim i vërtetë, të cilin nuk meriton askush përveç Allahut.

Zemër e shëndoshë është ajo zemër në të cilën nuk ka vend shirku, bile e adhuron Allahun me sinqeritet. Qëllimi i saj është Allahu. Atë e do, Atij i mbështetet, tek Ai pendohet, Atij i frikësohet dhe Atë e shpreson. Të gjitha veprat e saj janë të sinqerta. Për Allahun. Nëse e do dikë e do për hirë të Allahut, nëse jep, jep për Allahun, nëse nuk jep, nuk jep për hirë të Allahut. Mirëpo e gjithë kjo nuk mjafton përderisa të mposhtet dhe të ketë për gjykues vetëm Pejgamberin a.s. vetëm atë ta pasojë dhe vetëm atë ta ketë shembull, e jo njerëzit tjerë. Atij i nënshtrohet në çdo fjalë dhe në çdo vepër,

qofshin fjalë të zemrës që është akideja, ose fjalë të zemrës që është lajmi për atë që gjendet në zemër, qofshin vepra të zemrës që është qëllim, dashuria, urrëjtja, etj, ose vepra të gjymtyrëve. Pra Pejgamberi s.a.s.a. duhet të jetë gjykues në çdo vepër, qoftë e vogël ose e madhe. Nuk duhet t'i dalë përpara me ndonjë akide, me ndonjë fjalë, ose me ndonjë vepër ngase Allahu xh.sh. thotë:

"O ju besimtarë, mos bëni asgjë para Allahut dhe të dërguarit të tij".

(El-Huxhurat 1).

d.m.th. mos flisni derisa të flasni dhe mos veproni derisa të veprojnë.

Disa burra prej selefit kanë thënë: "Çdo vepër, pa marrë parasysh madhësinë e saj, i hapën dy libra. Njëra pse? kurse tjetra si? d.m.th. pse e bërë dhe si e bërë?"

Pyetja e parë; pyet shkakun nxitës për ta bërë këtë vepër. A thua vall ka qenë shkak kënaqësia e tij, interesi i tij, pozita, frika nga ofendimi, ose ka qenë shkak realizimi i adhurimit dhe afrimit Allahut.

Pra a e veproje këtë vepër për hirë të Allahut, ose e veprove për hir të epshit tënd?

Pyetja e dytë: pyet mënyrën e kësaj vepre, a thua vallë kjo vepër është në pajtim me synetin e Pejgamberit a.s., ose nuk ka qenë e përshkruar me sheriat? Pyetja e parë ka të bëjë me sinqeritetin, kurse e dyta me përcjelljen e Pejgamberit a.s., ngase Allahu xh.sh. nuk pranon asnjë vepër nëse nuk i posedon këto kushte. Mënyra për t'u liruar nga pyetja e dytë është përcjellja e Muhamedit a.s.. Pra zemra duhet të jetë e shëndoshë nga qëllimi jo i mirë, që e kundërshton sinqeritetin dhe nga epshi që i kundërshtohen përcjelljes. Kjo është zemra e shëndoshë, e cila të siguron shpëtim dhe lumturi.

2. Zemra e vdekur - Zemër e vdekur është ajo zemër që nuk ka jetë. Nuk e njeh Zotin e saj, e as që e adhuron, duke vepruar atë që e ka urdhëruar duke dashur dhe duke qenë i dashur prej Tij, mirëpo qëndron me epshin dhe kënaqësitë e tij, pa marrë parasysh se kjo vepër a e hidhëron Zotin ose nuk e hidhëron. Nuk i intereson ajo se a është i kënaqur Zoti apo nuk është i kënaqur. Atij i intereson të kënaqet ai vetë dhe e adhuron tjetërkend pos Allahut. Nëse e do dikë e do për hir të epshit të tij, e nëse e urren dikë, e urren për hir të epshit të tij. Nëse jep, jep për hirë të epshit të tij, e nëse nuk jep, nuk jep për hir të epshit të tij, e jo për hirë të Zotit të tij. Pra, epshi i tij është imani i tij, xhehli vozitësi i tij, kurse jovigjilenca vetura e tij.

Është e zhytur në mendime për realizimin e intereseve të tij në këtë kohë, i dehur me epsh dhe me dashuri. E thërrasin të vjen të Allahu xh.sh. dhe të ahireti mirëpo ai nuk i përgjigjet kësaj thirrjeje. Pason djalli. Kjo botë e kënaq dhe e hidhëron. Epshi e verbon dhe e bën shurdhmemec. Shoqërimi në këtë njeri është sëmundje, jeta në të helm kurse ulja me të, shkatërrim.

3. Zemra e sëmurë është ajo zemër që është e gjallë mirëpo ka të meta (sëmundje). Përbëhet prej dy materieve. Njëra e tërheq nga e mira e tjetra nga e keqja, e ajo i takon asaj që mbisundon. Kjo zemër e do Allahun, beson në Të, është e sinqertë ndaj Tij, Atij i mbështetet. Kjo është materia e jetës.

Mirëpo gjithashtu i do epshet dhe mundohet të përjetojë, ka zili kryelartësi, dëshiron të jetë e afirmuar në këtë botë. Kjo është materia e shkatërrimit. Kjo zemër gjendet ndërmjet dy rrugëve, rrugës së Allahut dhe ahiretit dhe rrugës që shpie në kënaqësi të tashme. Kjo zemër i përgjigjet rrugës që është më afër.

Pra, zemra e parë është e gjallë, e zgjuar dhe e butë.

E dyta e vdekur dhe e thatë.

E treta është e sëmurë, ose është më afër shpëtimit (shëndetit) ose më afër shkatërrimit (sëmundjes).

Allahu xh.sh. i ka përmendur dhe i ka tubuar në fjalët e tij:

"Ne nuk dërguam para teje asnjë të dërguar (resul) dhe asnjë peygamber (nebij), e që, kur ai dëshiron, të mos ia patë hedhur në atë dëshirën e tij djalli, dhe Allahu asgjëson atë që e hedh djalli dhe Allahu i fuqizon argumentet e Veta. Allahu është shumë i dijshtëm dhe me urtësi të madhe i rregullon çështjet. E për ta bërë atë (dyshimin) që djalli e hedh si provë për ata që i kanë zemrat e shtanguara. Nuk ka dyshim se pabesimtarët janë në një armiqësi të pafund. Edhe për të vërtetuar të dijshtëmit se me të vërtetë ai (Kur'ani) është i vërtetë prej Zotit tënd dhe kështu t'i besojnë dhe zemrat e tyre t'i binden Atij. E Allahu doemos do t'i udhëzojë ata që besuan, në rrugën e drejtë

(22:52-54).

All-llahu xh.sh e ndan zemrën në tre lloje: dy zemra të sprovuara dhe një zemër e shpëtuar.

Dy zemrat e sprovuara janë: Zemra e sëmurë dhe zemra e shtangaur, kurse zemër e shpëtuar është zemra e besimtarit, e cila i është bindur Zotit, i është mposhtur Zotit, i është dorëzuar Atij dhe është i qetë tek Ai.

Është bërë kjo ndarje ngase zemra ose gjymtyrët tjera duhet të jenë të shëndosha pa ndonjë të metë që të mund të veprojnë atë për të cilin janë krijuar. Ndërsa zemra del, përqëndrim nga shkakut i ashpërsisë së saj dhe mosveprimi i asaj që kërkohet prej saj, siç është gjuha që nuk flet, syri që nuk sheh, ose ka ndonjë sëmundje tjetër që nuk e lejon t'i bëjë këto vepra në formë të plotë dhe të drejtë.

Marrë nga revista: "Mevaridul-eman El-muntekamin Igathefil-Lehefan"

të Ibnul Kajjim el-xhevzie.

Enes Goga

kl IV-b

Personaliteti i Muhamedit a.s.

Nëse hedhim një shikim hartës së botës do të shohim se nuk ka vend më të përshtatshëm dhe më të volitshëm se Arabia, për këtë regjion univerzal. Arabia gjendet në mes të Azisë dhe të Afrikës, pra afër Detit të Kuq, por edhe jo larg Evropës.

Po, në qoftë se e lëshojmë shikimin tonë mbi faqet e historisë së lashtë do të shohim se asnjë popull që ekzistonte nuk ishte më i përshtatshëm për pranimin e pejgamberllëkut se sa arabët. Vërtet arabët ishin një popull i freskët dhe i vendosur. Edhe pse i ashtuquajtur i përparim shoqëror që ekzistonte të popujt tjerë që krijonte shprehje të këqia tek ata, në mes arabëve nuk ekzistonte një kësajsoj organizate shoqërore. Jeta e arabëve ishte jetë shumë e thjeshtë, por edhe pse jeta e tyre ishte e thjeshtë, te ta gjindeshim disa dukuri negative, që pasojë e këtyre dukurive ishte ajo se në mesin e tyre me mijëra vite nuk ishte paraqitur pejgamber (reformator) që t'i civilizojë dhe t'i pastrojë moralisht. Jeta shekullore e lirë dhe e pavarur në shkretëtirat rënore krijoi padituri të madhe në mes tyre. Do të thotë se u bënë aq të pashpirtë dhe këmbëngulur në injorancën e tyre sa që ishte e pamundur t'i humanizojë njeri i rëndomtë. Vërtetë, ishte një popull tek të cilët ndihej nevojë e madhe për përhapjen e mësimi të Pejgamberit Univerzal Muhamedit a.s.

Pastaj kur ta studiojmë literaturën (letërsinë) arabe do të bindemi se vërtet nuk ka gjuhë më të volitshme e të përshtatshme që të shprehen ideale të larta, që të sqarohen problemet më delikate të shkencës, që të preket zemra e njeriut dhe të udhëzohet për dëgjimin e Zotit. Fjali të shkurtëra mjaftojnë që të shprehin një sërë idealesh dhe njëherit lënë gjurmë të mëdha në zemër, tingëllim i thjeshtë i tyre nxit lotët në sytë tonë. Një kësillor gjuhe e pasur ishte fort e nevojshme, për fjalën e Zotit „Kur'anin“.

Pra këtu shihet urreësia e madhe e Zotit, që Ai e zgjidhi Arabinë për vendlindje të pejgamberit univerzal. Të shohim tani se sa ishte i veçantë dhe i jashtëzakonshëm personaliteti i bekuar, i zgjedhur nga allahu për këtë thinje të pejgamberit univerzal.

Në atë kohë sundonte errësira. Dituria që ishte në atë kohë nuk ishte e mjaftueshme që të ndriçojë horizontin e logjikës njerëzore. Njerëzimi më të vërtetë ishte në padituri dhe dyshime. Të gjitha konceptet e tyre për moralin, kulturën, civilizimin ishin primitive. Bënin jetë të vështirë dhe kishin tradita barbare, kënaqeshin me amoralitet, bixhoz, alkool, vrasje etj. Plaqkitja dhe vjedhja ishin deviza e tyre, ndërsa vrasja ishte shprehje e tyre.

Sa i përket besimit të tyre i preokuponte e njëjta sëmundje sikur edhe popujt të tjerë të botës. Kishin rënë në atë nivel sa që hyjnitë të tyre i kishin gurët, drunjtë, planetet e ndryshme etj. Ata nuk dinin asgjë për pejgamberët e mëparshëm, vetëm se u kujtohej se Ibrahim dhe Ismaili a.s. janë të parët e tyre, sa për mësimet e tyre nuk dinin asgjë.

Në atë kohë dhe në atë vend lindi një dritë që e shkëlqej horizontin e logjikës dhe të gjitha rrugët e Mekës. Babai i të cilit vdiq disa muaj para se të linte, kurse e ëma disa vite pas lindjes,

ku ky mbetet në mbikqyrjen e gjyshit ku edhe jeta e gjyshit të tij nuk zgjati shumë që pas disa viteve vdiq, d.m.th. Ky personalitet asgjësohet edhe nga ajo kulturë që ishte në atë kohë. Fëmijërinë e tij e kaloi si bari deflesh, ndërsa kur rritet, si tregtar. Ishte plotësisht i paarsimuar dhe analfabet. Asnjëherë nuk pati rast të uler me njerëz të dijsëm edhe pse ata nuk ekzistonin në Arabi. Kshte udhëtuar jashtë Arabisë, por këto udhëtime ishin tregtare. Edhe pse takonte njerëz të dijsëm dhe vërente forma të ndryshme të kulturës dhe të civilizimit, që këto takime ishin rastësisht, nuk mund të ndikojnë në formimin e një personaliteti fisnik me karakter njerëzor, i cili nuk mund të ndeshet atëherë në jetë.

Ta vëzhgojmë tani jetën dhe punën (vepren) e këtij personaliteti të njohur në kontekstin e shoqërisë arabe.

Ky njeri dallohet nga moshatarët e tij por edhe nga njerëzit e tjerë. Asnjëherë nuk ka gënjer. E tërë Mekja kishte bindje se ai ishte i ndershëm, fisnik dhe shpirtmë. Kurënjehet s'ka përdorur me gojën e tij fjalë të ndyta dhe të turpshme. Me tregti është marrë një kohë të gjatë, ku asnjëherë nuk kishte bërë ndonjë punë tregtare në mënyrë jo të ndershme dhe tradhtie. Ata të cilët punonin me të kishin besim në të dhe e quanin "El-emin" (i sigurtë, i besueshëm) sa që edhe gjërat më të çmueshme personale i lënin tek ai. Edhe pse ishte në mesin e një populli që e përdornin alkoolin dhe luanin bixhazin, ai asnjëherë në jetën e tij nuk e kishte përdorur alkoolin dhe nuk kishte luajtur bixhoz.

I rritur dhe i edukuar në një fis idhujtar, por kishte shpirt të denjë sa që e dinte se nuk ka në qiej dhe në tokë që meriton të adhurohet, përveç Zotit të Vetmit dhe të Vërtetë. Nuk përulëj pranë asnjë hyjnie, por në mënyrë instiktive e urrente çdo formë të adhurimit që nuk kishte të bëjë me Krijuesin. Shkurt, personaliteti i tij i jashtëzakonshëm ishte si guri i çmueshëm i cili shkëlqen në grumbullin e gurëve.

Pasiqë e kaloi mbi gjysmën e jetës së vet në mënyrë të ndershme, të civilizuar e të pastër, pason një kthesë në qenien e tij. Kështu që fillon të ndiej lodhje nga errësira dhe injoranca. Çdo gjë që e rrethonte e fyente shpirtin e tij. Atëherë vendos të tërhiqet në një kodrinë që të kalojë netët dhe ditët në vetmi duke adhuruar Allahun dhe duke agjëruar që zemra e tij të bëhet e pastër. Ku ajo kohë nuk zgjati shumë dhe befasisht hyjnore ndriqoi zemrën e tij. E lëshon vetminë e shpellës dhe i kthehet popullit arab me këto fjalë:

Idhujt që po i adhuronit ju, janë mashtrime të qarta, mos i ulni kokat para tyre dhe mos u gjunjëzoni para tyre. E tërë kjo gjithësi dhe krejt çka gjindet në të janë të Gjithëfuqishmit, Krijuesi i juaj, furnizuesi i juaj emri i të Cilit është Allah. Atë duhet të adhurojmë dhe të gjitha lutjet tona duhet drejtuar kah Ai. Ua shpejgonte normat edukativo - morale dhe i paralajmëronte për ditën e gjykimit, xhenetin, xhehenemin etj.

Pra ky është mesazhi, të cilin ai e solli. I tërë populli injorant u kthye nga ai. Fyerjet dhe gurët hidheshin pas

përsonalitetit të tij, por bindshmëria e tij në Krijuesin i duron këto mizori (tortura), jo një apo dy ditë por trembëdhjetë vjet me radhë, ku në fund detyrohet ta braktisë vendlindjen.

Mund të shtrohet pyetja:

Përse populli i tij u bë armik i përbetuar i tij?

E tërë kjo armiqësi bazohet në faktin se ai vërtet kërkonte të besohet dhe të adhurohet vetëm një Zot, predikimet e tij ishin kundër idhujtarëve na ndërronte zakonet e injorancës, ua ndalonte veprat e ndyta etj.

Pra ky paraqitet reformator jo i rëndomtë, politikan i famshëm, udhëheqës i madh. Ky beudin analfabet fliste aq me dituri dhe me urtësi sa që askush para tij nuk kishte folur kështu dhe as që do të flisë. Ai regullonte dispozitat etike dhe kulturore. Formulonte ligje sociale dhe ekonomike, marrëdhënjet ndërkombëtare aq urt dhe aq mirë, sa që tani dijetarët e famshëm mund të tregojnë vlerën e tyre vetëm pas gjumimit të gjatë.

Kur filloi të predikojë misionin e tij, e tërë Arabia ishte e shtanguar dhe e habitur me shkathtësitë e tij të përsosura oratorike. Ai ishte aq tërheqës sa që edhe armiqtë më të mëdhenjë të tij frikësoheshin ta dëgjojnë, prej frikës që mos po i prek thellë në zemër dhe t'i lëshojnë besimet e tyre të vjetra. ai ishte aq i pakrahueshëm sa që asnjëri prej poetëve dhe oratorëve arabë të rangut më të lartë, nuk ishin prodhuar diçka të njëjtë sipas bukurisë së gjuhës, sa që ky personalitet i lartë i shtyri armiqtë e vet të bashkuar ta prodhojnë së paku një kaptinë më të vogël e të ngjashme me atë që ai recitonte.

Në ditë të historisë botërore, figura mëdha e këtij personaliteti i tejkalon të gjithë njerëzit e mëdhenjë të të gjitha kohëve, sa që të gjithë heronjtë nacional duken shkurtësiq në krahasim me Muhammedin a.s. Asnjëri prej tyre nuk kishte njohuri të mëdha që të ndikojë në dy, tri ose më shumë lëmi të jetës njerëzore. disa prej tyre ishin burrështetas e disa strategë, ka prej tyre që tërë energjinë ia kishin kushtuar të vërtetave morale dhe shpirtërore ndërsa e kanë injoruar ekonominë dhe politiken por edhe në të kundërtën disa ishin të zënë me politikë e ekonomi, por moralin dhe jetën shpirtërore e lënin pas dore. Shkurt, hasemi në heronjë që kishin njohuri vetëm në një lëmi, ndërsa ky ishte personalitet që kishte njohuri pothuajse në të gjitha lëmenjtë të aktiviteteve njerëzore. Ai ishte ligdhënës dhe mësues i normave të moralit, ishte dritë shpirtërore dhe udhëheqës fetar sa që rrugën e tij tani e ndjekin më shumë se 1 miliardë njerëz.

Me personalitetin e tij ia ndikim të pashlyer në zemrat e shumë nxënësve të tij dhe i formoi sipas konceptit të fjalës së Allahut xh.sh.

Por tani njeriu mund të habitet, se në një periudhë të errësirës, para 1400 vjet, në një vend të paarsimuar, një bari dhe një tregtar analfabet, arriti deri aty që të posedojë ditë, dituri e aftësi të tilla dhe shkathtësi shumë të zhvilluara e të mëdha.

Mund të themi se nuk ka asgjë për çudi në mesazhin e tij. Të gjitha këto janë prodhim. Nëse është ashtu, atëherë ai duhet të proklamohet si Zot, ku njerëzit në atë kohë prej imagjinatës së pastër dhe pa i brejtur aspak ndërgjegjia adhuronin zjarin,

drujtë dhe gurët, me gëzim do të pranonin një personalitet të çuditshëm siç është Muhamedi a.s. për Zot.

Por jo. Sepse thënia e tij është e kundërt, ku thotë: "Unë jam njeri si dhe ju. Asgjë nuk kam sjell me iniciativën time. Tërë këtë ma ka shpallur Allahu xh.sh. Krejt çka posedoj unë i takon Atij. Por çdo fjalë më frymëzoi Allahu dhe e tërë lavdata i takon Atij. Tërë këto suksese të jashtëzakonshme (mu'xhizet) të cilat flasin në dobinë time në sytë e juaj, të gjitha këto ligje dhe parime të cilat i dhash, nuk janë prej meje, sepse unë do të isha i paafte të prodhojë gjëra të tilla vetëm me aftësitë e mija personale, por janë nga Krijuesi i kësaj gjithësie, Allahu xh.sh. Krejt çka urdhëron Allahu unë e veproj, ndërsa çka e ndalon Ai, unë e shpalli".

Por njëherit duhet të dimë se mesazhi i tij nuk ishte i drejtuar vetëm një populli ose një vendi a kohe. Ai ishte peygamberi i vërtetë për tërë njerëzimin. Kur'ani e urdhëron Muhamedin a.s. të thotë: "Unë jam peygamberi i Zotit për mbarrë botën". Njëherit na e përshkruan misionin e tij "mëshirë për të gjithë njerëzit e botës". Prandaj pas tij nuk ka nevojë për peygamber tjetër të ri, që edhe në Kur'an është i quajtur "Hatemun-nebijin" pra peygamberi i fundit prej vargut të gjatë të peygamberëve. Kur'ani dhe Hadithi janë shumë kategorik në këtë çështje. Kur'ani thotë:

"Muhamedi nuk është baba i asnjërit prej juve, por ai është peygamber i Allahut dhe vullë e të gjithë peygamberëve, e Allahu është i dijshtëm për çdo send". (El-Ahzab 40).

Ndërsa peygamberi ka thënë: "Nuk do të ketë peygamber pas meje". Në një rast tjetër thotë: "Raporti im në vargun e gjatë të peygamberëve mund të ilustruhet në krahasim me një pallatë. Pallati është i ndërtuar bukur. Çdo gjë në të është e kompletuar përveç se në një vend mungon vetëm një tullë. Unë e kam mbushur atë vend dhe tash pallati është kompletuar". (Buhariu dhe Muslimi)

Pra i tillë ishte peygamberi ynë, lajmëtar i madh i Zotit. Jeta dhe ideja e tij, singjeriteti dhe devotshmëria e tij, ideologjia dhe veprat e tij janë fakte të pamohueshme për vërtetësinë e mesazhit të tij. Çdo njeri që e studion jetën dhe veprën e tij do të vërtetojë se ai më të vërtetë ishte peygamber i zotit dhe se Kur'ani është fjala e vërtetë e Zotit.

Duke iu falënderuar Allahut xh.sh. për dërgimin e Muhamedit a.s. mund ta kuptojmë mirë se ne tani e njohim rrugën e drejtë Islame. Tani s'na mbetet tjetër vetëm se ai i cili dëshiron të gjejë të vërtetën dhe të bëhet musliman i ndershëm dhe i thtar i singertë i rrugës së Allahut xh.sh., duhet të besojë në peygamberin e fundit të Zotit dhe ta ndjekë rrugën të cillën ai ua shpejtoi njerëzimit. Pra kjo është e vetmja rrugë e vërtetë e suksesit dhe e shpëtimit.

Jakup Çunaku kl IV-b

Lëvizjet shkatërruese në historinë Islame

Islami iu garanton besimtarëve të vet, lirinë e plotë të mendimit dhe të fjalës. Kështu feja islame i ka tërhequr njerëzit dhe është fe e përhapur në të gjitha kontinentet e botës. Muslimanët e parë kanë kuptuar islamin si çlirimtarë të mendimit të lirë njerëzor nga mënyra e gurëzuar dhe statike e mendimit.

Kur'ani - shpallja e fundit e Zotit është bazë për zgjidhjen e shumë problemeve e dilemave njerëzore. Pas Kur'anit vjen fjala, vepra e tradita e pejgamberit të fundit Muhammedit a.s. "Sunneti" i cili konsiderohet si burim i dytë i Sheriatit Islam. Pra Kur'ani është shpallja e fundit, ndërsa pejgamberi i fundit është Muhammedi a.s. Çdo tentim për të shpikur ndonjë shpallje tjetër apo për t'u shpallur pejgamber, është i rrejshëm.

Ata të cilët nuk don të pranojnë Islamin, mund të jetojnë në shtetin Islam duke e ruajtur fenë apo ideologjinë e tyre. Këtë e garanton edhe ajeti i Kur'anit: "La ikrahe fid-dini" - "Nuk ka dhunë në fe".

Pra ata të cilët e pranojnë Islamin janë të obliguar t'u përmbahen mësimëve të tij dhe ta komentojnë e shpjegojnë Islamin pa dalë nga binarët të cilët i ka vendosur Kur'ani i madhëruar.

Pas vdekjes së Muhammedit a.s. shumë popuj u larguan nga Islami. Por, gjatë kohës së kalifit të parë u luftuan të gjithë murtedet dhe shumica e tyre u kthye prapë në Islam. Në atë kohë kishte grupe të cilët e kishin pranuar Islamin por prapë kishin lidhje me fenë e tyre të vjetër. Ato njihen si grupe munafike. Në krye të këtyre grupeve ishin edhe persona që pretendonin se janë pejgamberë si Musejleme Rrenacaku etj. Është i njohur edhe Abdullah bin Sebe çifut, i cili e kishte pranuar Islamin me hipokrizi dhe i nxiste muslimanët në grindje e përçarje.

Pas vdekjes së Aliut r.a. dhe birit të tij në mënyrë tragjike u paraqitën grupet Shi'ite që pretendonin të merrnin pushtetin, duke thënë se vetëm pasardhësit të Aliut r.a. iu takon pushteti. Këtu e shfrytëzon rastin munafiku i njohur Abdullah bin Sebe, i cili paraqitet si mbrojtës i shi'itëve. Ai thotë se "Aliu do të kthehet sepse në të është një pjesë e Zotit dhe ajo nuk mund të vdesë. Bubullima është zëri i tij ndërsa vetëtimja është qeshja e tij".

Ai themelon lëvizjen "Batinije" duke thënë se sheriatu ka dy pjesë kryesore: të dukshmen dhe të padukshmen (fshehtësinë). Të dukshmen mund ta kuptojë çdo njëri, ndërsa të fshehtën vetëm imamët shi. Pra, kështu ata filluan ta shpjegojnë verbërisht Islamin.

Batinijtë

Në ditët e para të ekzistimit këta nuk patën lëvizje të organizuara, por në vitin 270 h. më lajmërimin e persianit Mejmun bin Dejsan filloi njëfarë organizimi i tyre. Batinijtë u ndanë në disa grupe si Haremijte e Babil el Haremit në Azerbejxhan. Keramitet e Hamdan bin Karmit ndërsa vend me rëndësi zënë edhe hashashunët. Vlen të theksohet se në vitin 317 h. Keramitet e sulmuan dhe e morën Mekën. Ata mbyllën një numër të madh të haxhinjve dhe e morën Haxherul-Esvedin. Atë e dërguan në Bahrein duke e formuar atje edhe shtetin e tyre. Haxheri-Esvedi u kthye prapë në Qabe me intervenimin e halifit Fatimi.

Të gjitha këto lëvizje kanë një qëllim kryesor: shkatërrimin e Islamit. Ato lëvizje shpifën hadithe lidhur me ardhjen e Mehdisë - imamit të fundit shiit (të dymbëdhjetit) i cili kishte humbur. Disa flitnin për ardhjen e Aliut r.a. e disa kthimin e Mehdiut e shihnin në personalitetin e Mehdi Bin Hasan el-Askari. Ata thonin se Mehdiu nuk ka vdekur dhe ka kontakte me shiit dhe një ditë do të kthehet. Mehdiu ka lindur në Shaban 255 h.

Kadijanijtë

Themelues i kësaj lëvizje është Mirza Gjulam Ahmed. U lind në vitin 1839 në krahinën Benxhab të Kadijanit. Kadijani është 105 km larg Lahores, qytet pakistanez. Të parët e Mirza Gjulamit erdhën në Indi nga Samarkandi në vitin 1530. Ata u pasuruan duke bashkëpunuar me kolonistët anglezë.

Pasi kishte prindër të pasur Mirza Gjulam i shkollua në shtëpi ku e mësoi Kur'anin dhe arabishtën. Gjithashtu e mësoi persishten dhe duçka nga medicina. Pasi nuk kishte mësuar të shkolluar musliman, devijoi nga rruga e drejte. Një kohë punoi për anglezët në qytetin Shejlekut të vice-guvernieri i Indisë.

Pas katër viteve (1866) më kërkesën e babait të vet, u kthye në shtëpi dhe vazhdoi "studimin" e Islamit dhe fenë në përgjithësi. Në vitin 1880 botohet pjesa e parë e "El-Berahinul - Ahmedije".

Dy vjet pas kërkon që bota islame ta pranojë për reformator islam. Vepra e tij "El-Berahinul-Ahmedije" u shkrua në katër pjesë, shkallë-shkallë sipas rrethanave. Në vitin 1905 shkoi në Nju-Delhi për t'iu mbajtur ligjëratat muslimanëve të atjeshëm. Por nuk hasi në pritje të mirë, dhe pas protestës së muslimanëve u kthye prapë në vendlindje.

Në maj 1908 shkoi në Lahore ku edhe vdiq. Familja e tij vendosi ta varrosë në vendlindjen e tij Kadijani. Mirza Gj. Ahmedi mësimet e tij i konsideronte islame. Vetën e konsideronte si reformator dhe përtrier të mendimit islam. Ndonjëherë ai ka rënë në kundërshtim me vetën e tij. Njëherë e pranon profetësinë e Muhammedit, që më vonë ta quajë vetën Mesih i prituri dhe Shpëtimtar. Ja disa thënie të tij: "Profetizmi i Muhammedit a.s. ka qenë i kufizuar vetëm në të, dhe askush nuk është shpallur pejgamber përveç Muhammedit".

"Me të vërtetë Zoti ka dërguar te ky popull një Mesih më të madh e më të mirë në çfarëdo shqimi se Mesihu i mëparshëm dhe e ka quajtur Gjulam Ahmed". Të mos flasim për thënien e tij se është bir i Zotit. Estagfirullah!!!

Pasi kishte lidhje të mira me Anglinë, ai e ndaloi Xhi-hadin kundër saj duke thënë se ajo është Mbretëri Qiellore e Zotit. Pejgamberët e Zotit i kanë mbrojtur të varfërit, të shkretët dhe kanë luftuar për barazi dhe liri të gjithë njerëzve. Përkundrazi, Kadijanijtë luftojnë për pasuri, dominim të forcës dhe eksploatin. A thua pra, si mund të shpallet pejgamber Mirza Gjulam Ahmed kur nuk posedon asnjë cilësi të pejgamberëve të Zotit? Bota islame qysh në fillim ka marrë masa kundër Kadijanive. Mesimet e tyre janë të ndaluara me ligj në Arabinë Saudite, EBA, Pakistan dhe Egjipt. Vendi i parë që ndaloi sektin Kadijani me ligj për çudi ka qenë India.

Ahmedijtë

Ahmedijtë janë degë të Kadijanive. Edhe këta e konsiderojnë themelues të vetin Mirza Gulam Ahmedin. Ndarja u bë në vitin 1914. Kadijanijtë thonë se M.G.Ahmed i ka qenë pejgamber i Zotit, ndërsa Ahmedijtë thonë se ka qenë vetëm Përtëritës dhe reformator. Pas vdekjes së M.G.Ahmedit, prijës u bë bashkëpunëtori i tij Nuredini. Këtë e kundërshtoi, bashkëpunëtori tjetër i Mirza Gulanit Hoxha Kemaludin. Ai shkoi në Lahore dhe e formoi grupin Ah-

medi "Shoqëria Ahmedije për përhapjen e Islamit". Ata që nuk shkuan në Lahore iu bashkuan birit të M.G.Ahmedit, Mirza Muhamedit dhe ende quhen Kadijani.

Ahmedijtë sikur edhe Kadijanijtë e konsiderojnë Anglinë mbrojtësen më të madhe të Islamit dhe muslimanëve. Ahmeditë mendojnë se duhet t'i kenë xhamitë dhe imamët e vet. Nëse Ahmediu falet pas muslimanit duhet ta përsërisë namazin. Ata thonë se duhet të heqin dorë prej botes islame pasi që edhe ajo ka hequr dorë prej tyre. Ata e konsiderojnë musliman atë që: Beson se Zoti është një, se Muhamedi a.s. është pejgamber i Zotit dhe kush beson në gjithë atë që e ka thënë Mirza Gulam Ahmed. Ahmedijtë janë shumë aktivë dhe mund të takohen gati në tërë botën, por në krahasim me Kadijanijtë ata janë pakicë.

Babijtë

Themeluesi i kësaj lëvizjeje është Mirza Ali Muhamed Esh-Shirazi. Por filluesi i parë i kësaj lëvizjeje është Ahmed el-Ihsai i lindur më 1753. Ai i takonte lëvizjes shi'ite që e adhurojnë Aliun r.a dhe e presin ardhjen e tij. Ihsai dhe ithtarët e tij nuk e besojnë ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit. Ai bazohet edhe në mësimet Batinije.

Veprimtaria e tij plotësohet dhe përhapet pas takimit të tij me Kazim Rishtin në Teheran. Nga Teherani ata udhëtojnë në Kerbelë (Irak) dhe e vazhdojnë veprimtarinë e tyre. Kerbelaja nuk është zgjedhur rastesisht. Ajo është qendër e shi'ijëve të cilët në atë kohë ishin të gatshëm të bashkëpunonin me secilin i cili e predikon ardhjen e Mehdiut (imami i 12-të i shi'iteve).

Kazim Rishti e përgatiti Mirza Ali Muhamedin që ta kryejë misionin e Mehdisë së prituri. Ai thoshte: "I premtuari (Mehdiu) jeton në mesin tuaj, koha e ardhjes së tij është afër dhe përgatituni për ardhjen e tij. Do të lajmërohet pas vdekjes sime. Ne ju mbetet vetm ta gjeni dhe ta pasoni.

- vazhdon në numrin tjetër -

Lulëzim Bloka

III/a

Mënyra e ftesës në Islam

Allahu xh.sh. e zgjodhi njeriun misionar të Vetin në Tokë, por që ai ta ketë këtë meritë e këtë rol e mësoi për gjërat që nuk i diti.¹ Zgjodhi disa njerëz nga mesi i tyre dhe i mësoi ata (Pejgamberët) përmes Melekut; Si ta gjejnë rrugën e drejtë e njëherit edhe si t'i ftojnë të tjerët në rrugën e drejtë të Besimit - Islam. Është përseritur kjo gjeneratë pas gjeneratave derisa erdhi koha e përfundimit të mësimit hynjor (Shpalljes) dhe dergimit të Pejgamberit të fundit Muhamedit a.s. Ku i thuhet: "Ti (O Muhamed) thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira".²

Me këtë ajet Allahu xh.sh. e mëson dhe e urdhëron Muhamedin a.s. se si t'i ftojë njerëzit në rrugën e drejtë të Islamit - Dorëzueshmërisë. Ata të cilët e kanë zgjedhur rrugën e Islamit janë trashëgimtarë të pejgamberëve, fjala është për ata të cilët e studiojnë këtë rrugë, pasi që Pejgamberi a.s. në një hadith po na sqaron se: "Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve".

Pra, ata të cilët posedojnë diturinë Islame e kanë për detyrë që atë dituri ta shpërndajnë, sikurse e kanë të pasurit ta shpërndajnë pjesën e caktuar nga pasuria e tyre. Sadaka e diturisë është shpjegimi diturisë e Islame të tjerëve. "Më i miri prej ymetit tim është ai i cili e mëson Islamin e praktikon atë dhe i fton të tjerët në të" - thotë Pejgamberi ynë - Paqa dhe shpëtimi i Allahut qofsh mbi të.

Nga kjo mund të konkludojmë se ata që e dojnë Allahun xh.sh dhe Pejgamberin a.s. d.m.th. janë të përcaktuar për Islam, e studiojnë atë, janë kompetentë për t'ua shpjeguar të tjerëve do të thotë e kanë obligim. Po që se e shohim të ligën jo Islamen në rrethin apo mesin ku jetojnë e kemi obligim

që ta luftojmë atë e ta shpjegojmë të mirën - Islamin e jo të bëhemi sikur ata që kanë Imanin e dobët e të themi: O Zot, unë nuk jam i kënaqur me këtë e këtë por nuk mundem ta luftoj.³ Por duhet ta dimë se Pejgamberi ynë Sava ka thënë: Kush prej jush e sheh ndonjë të keqe në mesin e juaj le ta luftojë atë me dorë, e nëse s'ka mundësi me gjuhën e nëse s'ka mundësi me zemër kjo është Imani i dobët".⁴


Por para se t'i ftojmë të tjerët në Islam duhet që t'i plotësojmë disa kushte: Së pari të jemi të sinqertë në Imanin tonë ta njohim atë gjuhën arabe t'iu përmbahemi më përpikëri rregullave e detyrave islame e pastaj ta dimë mentalitetin, gjegjësisht diturinë që e posedon bashkëbiseduesi ynë e pastaj ta ftojmë e t'ia shpjegojmë atij Islamin.

Pra ne duhet t'i dimë dhe t'i zbatojmë urdhërat Kur'anore për ta plotësuar meritën dhe rolin që e kemi zgjedhur vetë.

Kur njeriu e plotëson rolin e tij sikur e ka urdhëruar Kur'ani atëherë e provon se e ka merituar nderin që ia ka dhënë Zoti atij.⁵

Kjo është kusht për jetesën e mëtutjeshme dhe realizmin e opcioneve tona e gjithashtu edhe orientim i drejtë i shoqërisë anëtarë të së cilës jemi edhe ne. Po që se e lëmë që shoqërinë ta udhëheqin dhe udhëzojnë të ligët atëherë ka mbarruar ajo.

Njeriu që të jetojë një jetë nga e cila askush nuk do të ketë dëm e që të ketë mundësi t'iu përgjigjet e t'i zbatojë të gjitha detyrat që i parasheh Islami, së pari duhet të ketë kujdes në frenimin e vetvetës.⁶



Si' e cekëm më lart që nëse dëshirojmë ta kryejmë obligimin për t'i ftuar të tjerët në Islam, duhet ta njohim edhe mentalitetin që e kanë ata. Njëri i sotëm nën ndikimin e filozofive e botëkuptimeve të ndryshme, veçmas ekzistencialo-atheiste mjaft të përhapura në këtë kohë por edhe nën ndikimin e faktorëve të tjerë⁷ është injorant sa i përket fesë andaj duhet shpjeguar të vërtetën edhe pse do të hasë në shumë vështirësi. Bashkëkohasve tanë çuhet t'ua shpejgojmë të vërtetën duke iu folur në mënyrën si ata e kuptojnë duke u shpjeguar edhe librat e dobëta të cilat i kanë mesuar ata, pra duhet pasur në konsideratë mënyrën se si janë edukuar ata, burimet nga të cilat i kanë marrë njohuritë janë vetëm luhajtje e dyshim, thënë shkurtë - Kufër. Pabesim.

Një gjë të tillë e shpjegon edhe dijetari i njohur Francez Rozhe Garodi i cili ishte prej liderëve Marksist Leninist por e ka zgjedhur Islamin si rrugë të jetës. Në Librin e tij të quajtur "Gjallërimi Islamik" shkruan: "Ajo që ka kontribuar para 4 vitesh që nga Sokrati deri te Kanti nga Kirkegedi gjer te Marksi, nga Niçe gjer te Huserli kjo nuk është feja por dyshimi."⁸

Edukimi i fëmijëve tonë është i ngritur nga bazat e kalbura dhe i mbushur plot e përplot me injorancë alkool, etj. dhe është karakteristikë përveç tjerash edhe nga të braktisurit e Zotit⁹ duke mësuar vlera të pa vërteta e trillime për Islamin. Sa e sa kemi degjuar nga mësues e profesorë tonë të pa ndërgjegjshëm të cilët shkaktojnë hutë dhe fusin dyshim në ekzistimin e Zotit në mënyrë direkte apo indirekte, duke i quajtur argumentet e Kur'anit përralla trillime e legjenda.¹⁰ Kështu kisha rastin të dëgjoja një tregim mjaft interesant për xhenetin e xhehnemin nga një intelektual i popullit tonë (që vështirë më vjen ta ceku me emer). Ai tregon për teginet e xhenetit që i ngjajnë romanit për fëmijë "Liza në Botën e Qudirave" Ku Liza e vogël ëndërron të biseduarit më kafshët e shpezët e ndryshme dhe thotë se këtë e ka të bazuar në Kur'an, duke mos e ditur i gjori se unë e lexoj dhe sado pak e kuptoj Kur'anin (ELHAMDULILAH) dhe këso përralla nuk gjinden në të. A thua duhet të heshtim në këso marrina?!

Pa marrë parasysh se kush thotë një turp të tillë ne duhet të reagojmë dhe t'i themi: Ju lutem Kur'an! pallavra të tilla nuk pranon. Kështu deri dje na trillonin edhe për atdheun e kombin tonë që fal erërave demokratike po dalin në shesh të vërtetat...

Moshatarët tanë duhet të na dhimbën se nuk kanë pasur rastin të dëgjojnë të vërtetën për Islamin dhe duhet kuptuar gjendjen e mjeruar të tyre dhe të mundohemi t'i nxjerrim nga errësira në të cilën janë futur thellë. Kurse librat shkoll-

lore nga të cilat janë edukuar të rinjtë tanë janë të mbushura me skepse mllëf e urrejtje ndaj Islamit.¹¹

Kështu në librat e biologjisë ende shpjegohet teorai Darwiniste e prejardhjes se njeriut nga majmuni ose për shembull figurat e ndritshme të kulturës sonë janë të injoruar dhe thuhet e pa vërteta për ta si për Hasan Zuko Kamberin ku thuhet..." Protestë të veçantë bën kundër Pejgamberit dhe Perëndisë që sipas tij nuk i përfillen të drejtës por vetëm rrenës".¹²

Hasan Zuko Kamberi ishte fetar i madh dhe e kishte shkruar "Mevludin" që në këtë libër përmendet vetëm kalimthi, A s'është ky një krim?! Andaj nuk duhet të na çudit injoranca e të rinjve tanë të cilët janë edukuar nga njerëzit e tillë injorantë e mashtrues vetëm e vetëm për t'i fituar tituj Prof. e Mr. që sot i kanë dhe krenohen me to e të cilat i kanë fituar duke e fshehur të vërtetën për kombin e vet.

Por duhet t'i thërrasim në rrugën e Allahut duke u shpjeguar të vërtetën duke i këshilluar me butësi e polimizuar me ta në mënyrën më të mirë siç po na mëson edhe ajeti që e cituam më lart: "Ti (Muhamed) thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe plimizoj me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira".

Ky ajet i drejtohet Muhamedit a.s. por edhe dijetarëve të cilët dëshirojnë të jetë kënaqur Allahu me ta dhe të jenë Trashëgimtarë të pejgamberëve. Lusim Allahun xh.sh. që t'i udhëzojë në rrugën e drejtë të rinjtë tanë dhe ata që dëshirojnë ta gjejnë meshirën e Tij t'ua mundësojë atë kurse atyre të cilët bëjnë da've t'ua shtojë diturinë imanin e durimin e t'i pastrojë nga mëkatet që në ahiret të jenë pran Pejgamberëve a.s.

*Refik Gerbeshi
F.S.I Prishtinë.*

1. Kur'an Përkthim me Konsentin në gj. Shqipe Mehinë 1413 h.

2. Po aty.

3. Abdullah nasih ulvan "Drejtuar trashëgimtarëve të Pejgamberëve Prizren 1993

4. 40 hadithe të Ibn Regjepit

5. Iman vehbi Ismajli Predikimet e xhumasë dhe Bajramëve Albanian Islamic centre Harper woods mi U.S.A 1988 f. 197

6. Naim ef. Ternava Morali Islam AILAKU Prishtinë 1993.

7. Hasan Qengiq Temat Islame Logos a Shkup 1994 f. 86

8. Rozhe Garodi Gjallërimi Islamik, Gjakovë 1991

9. H. Qengiq Temat Islame

10. Drejtuar Trashëgimtarëve të Pejgamberëve 1993 Prizren

11 Po këtu

12 Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore për shkollë të mesme viti I 1984 Prishtinë f. 202.

Intervistë e huazuar

Si e përqafova Islamin?

Intervistoi: Amal Sheref

Falënderimi i takon vetëm Allahut xh.sh për mirësinë e udhëzimit në Islam. Atë mirësi të cilën Allahu xh.sh ia dhuron secilit do prej robërve të Tij. Vullneti i Allahut deshi që edhe disa njerëz nga Evropa dhe Amerika ta pranojnë Islamin, madje-madje ne sot i gjejmë nga muslimanët të cilët më përpikëri u përmbahen rregullave të Kur'anit dhe Sunnetit.

Mysafir i yni në këtë numër është 32 vjeçari Nimetullah Jusufi, me fytyrën e tij të ndritshme dhe edukatën e lartë, do të na rrëfejë mbi jetën e tij në vendlindje - në Argentinën e largët, që nga fëmijëria e deri më sot.

Nimetullah Jusufi:

- Kam lindur në Argentinë. Babai im ishte çifut i ardhur nga Rusia, kurse nëna krishtere nga Argjentina. Babai im nuk besonte Zotin, edhe pse gjyshi im ishte çifut shumë i devotshëm. Ndërkaq nëna e besonte Zotin vetëm me zemër kurse ritualet fetare nuk i kryente fare! Mësova në dy shkollë, në atë çifute dhe krishtere në të njëjtën kohë, gjegjësisht, në mëngjes dhe mbrëmje. Nuk ndjeja kurrfarë kureshtjeje për asnjërën prej këtyre dyave. Ndaj edhe për këtë arsye deri në moshën 15 vjeçare nuk e besova Zotin.

- Fillimi i udhëzimit - hidajetit

Në këtë kohë u nda i ati dhe mbeta vetë me nënën ku në të njëjtën kohë punoja dhe mesoja.

Mësova filozofinë, mirëpo, edhe në këtë shkencë nuk gjeja atë që dëshiroja. Dëshiroja të bëj diç por nuk dija se çka. E mësova gjuhën frienge katër vjet rradhazi dhe kur arrita moshën 22 vjeçare dëshiroja të udhëtoja. Pasi që tubova një shumë të hollash vendosa të udhëtoj.

- Udhëtimi

Vazhdova të udhëtoj me auto-stop plot gjashtë muaj. Gjatë kësaj kohe vizitova 15 shtete derisa arrita në Nju-Jork, ku punova një vit dhe arrita që gjatë këtij viti të blej një shtëpi, automobil dhe të kam disa të holla. Më ofruan një punë në një kompani me të ardhura të majme, mirëpo këtë e refuzova ngase pasuria dhe pozita shoqërore nuk më realizonin (plotësonin) kënaqësinë e dëshiruar... Vendosa të udhëtoj në Evropë, pikërisht në Paris, ku u punësova në një prej shumë hoteleve të tij dhe mësova dramaturgjinë dhe kinematografinë me një afat prej një viti e gjysmë. Mirëpo, megjithatë jeta ime e re me dukej vetëm mashtrim, dhe ajo që më shtonte më shumë këtë ishin francezet, posaçërisht të rinjtë e arsimuar, të cilët pas vitit 1968 menduan në transformime të mëdha në shoqërinë e tyre. Kjo ishte ajo që quhej "revolucion për emancipim", dhe besuan se një gjë e tillë është e mundur, mirëpo, pas një viti e gjysmë edhe pse kjo lëvizje ishte e vërtetë nuk arriti të japë rezultate të dëshirueshme.

Në Francë kisha shtëpinë time, automobil dhe shumë shokë, mirëpo, të gjitha këto nuk më dhanë atë që dëshiroja - kënaqësinë e vërtetë. Vendosa të udhëtoj, mirëpo, kësaj here lash Parisin pa kurrfarë qëllimi vetëm e vetëm që të jetoj dhe të vdes në një vend tjetër.

- Shpërngulja në Lindje

I vizitova të gjitha vendet e Evropës. Në Itali bleva hartën e botës në mënyrë që të shoh se ku të udhëtoj. I vizitova shtetet Islame Turqinë dhe Sirinë. Vendosa që të udhëtoj për në Izrael që t'i vizitoj të afërmit e babait. Mirëpo, në kufirin e Sirisë më ndaloi roja me armë dhe kur pyeta për arsyet e ndaljes njëri prej tyre më tha: Ti nuk dike gjë dhe nese tenton të kalosh andej kufirit do të të shpërblej me plumb. U pikëllova pa masë dhe pasi që nuk munda t'i kuptoj fjalët e këtij ushtari sepse unë nuk dija mbi problemet e Lindjes së Mesme dhe për Islamin, u ktheva në Turqi. Kjo natë mu duk shumë e gjatë, isha tepër i hidhëruar, piva shumë dhe gjatë udhëtimit hyra në një park, u ula nën një pemë dhe fillova të qajë më të madhe. Isha krejtësisht i vetmuar dhe nuk kisha kurrfarë lidhje me familjen. Pas të qarit kisha fjetur për një kohë. Më vonë erdhi një plak dhe më ra disa herë në krahëror, eci dhe u kthye me një filxhan të kafesë, u ul pranë meje duke mos thënë asgjë!

Pas kësaj udhëtoja për në Iran, Afganistan dhe Pakistan, ku në veri të Pakistanit u takova me disa evropianë të cilët udhëtonin për në Indi. Me ofruan që edhe unë të udhëtoj me ta dhe të mos udhëtoja për në Karaçi, sepse sipas atyre ai (Karaçi) nuk ishte i bukur! Mirëpo, unë u përgjigja se gjithsesi do të udhëtoja për aty edhe pse nuk dija arsyen. Gjatë rrugës kuptova se më mungonin të hollat dhe nuk dija nëse i kisha humbur apo m'i kishin trëmbyer evropianët.

Edhe pse nuk dija gjuhën e këtyre viseve, edhe pse nuk kisha të holla, për çudi nuk ndihesha i hidhëruar! Fillova të vizitoj shumë xhamia në të cilat qëndronin njerëzit e mirë të Zotit. Pakistanezët më dhanë ushqim, veshmbathje, qetësim shpirtëror dhe dashurinë pa kurrfarë kompenzimi. Që tani e di se ata një gjë të tillë e bëjnë që vetëm e vetëm të merren shpërblim nga Allahu xh.sh. e jo për diç tjetër. Fillova të ndiej se jeta e këtyre njerëzve plotësisht ndryshonte nga jeta e vendeve të ashtuquajtura "të zhvilluara", sepse vendet perëndimore mendojnë se të zhvilluarit e njeriut ngritet mbi baza materiale ndërkaq, të zhvilluarit material e gjejmë të kufizuar dhe ai nuk është i gjithmonshëm. Ndërkaq njerëzit në Pakistan në brendinë e tyre kishin diç tjetër nga ajo materiale, edhe pse ky diç ishte i padukshëm ai në të vërtetë ekzistonte, dhe ata me të vërtetë, ishin njerëz të pastër në brendi dhe jashtë e që është shkak i qajtes së Pakistanit "tokë e të pastërve"

- Njohja e Allahut dhe e Islamit

Në Ramazan të vitit 1978 më morën policët pakistanezë, dhe kur arriti akshami (iftari) pash policët dhe të burgosurit tjerë të cilët hanin (bënin) iftare, e, edhe unë së bashku me ta. Që nga ky çast fillova t'i afrohem Islamit. Pranë zyreve të policisë gjendej një xhami e vogël në të cilën muezini e thirrte ezanin me gjithë zemër gjë që më preku thell-thell në zemër, më tronditi, më tërhoqi dhe më bëri që edhe unë të shkoj në xhami e të falcm, edhe pse nuk e dija abdesin dhe rregullat e namazit. Më pas mësova abdesin dhe lexova disa libra të vogla mbi Islamin dhe gjithashtu mora disa njohuri sa do të pakta mbi të - Islamit. Gjatë syfytit, edhe pse ushqimi nuk ishte i mjaftueshëm, fillova të kuptoj se këta ishin njerëz të thjeshtë, por me zemra të patërta. Dhe kur vendosa të pranoj Islamin më morën dhe më dërguan në një xhami ku deklarova Islamin tim.

Të ndëruar lexues, ishte e domosdoshme që të ndalemi pak dhe t'i shtojmë disa pyetje vëllaut tonë, të cilat do të na tregojnë më detajisht mbi jetën, personalitetin dhe pranimin e Islamit nga Nimetullah Jusufi

Cili ishte shkaku kryesor që ju shtyri të pranoni fenë Islame?

- Besoj se shkak kryesor që unë të pranoj Islamin ishin ata muslimanë të cilët besojnë sunnetin dhe imanin e tyre e reflektojnë në vepra dhe në sjelljet e tyre Islame të cilat ma pushtuan zemrën time dhe ma lehtësuan rrugën deri te njohja e së vërtetës. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: "... se ai që mbyl ndokend, i cili s'ka mbytur askend, ose atë që nuk ka bërë çrregullime në tokë është sikur t'i mbyshësh të gjithë njerëzit, e nëse ndokush bëhet shkaktar që të shpëtojë jetën e ndokujt - është sikur t'ua shpëtojë jetën e të gjithë njerëzve". (El-Maide, 32). Ndërkaq, Pejgamberi a.s. thotë: "Që ta drejtojë Allahu xh.sh. një njeri përmes toje është më mirë se dynjaja dhe gjithëka ka në të".

Ku i fituat njohuritë (e para) Islame?

- Në Pakistan.

A kanë ndryshuar marrëdhëniet e tua me familjen?

- Pas pranimit të Islamit marrëdhëniet e mia me familjen ndryshuan plotësisht. Kur fillova t'i konigjoj marrëdhëniet dhe sjelljet e mia përputhshmërisht me Islamin kuptova se jeta ime e mëparshme ishte plot e përplot me gabime. Shkova dhe u kërkova falje anëtarëve të familjes për gabimet e mia të bëra ndaj tyre më herët. Kërkova nga ata falje. Letra ime e pare ishte për nënën time, e cila mjaft ndikoi tek ajo. Nëna menjherë filloi të interesohet për këtë fe, e cila rrenjësisht e kishte ndryshuar të birin e saj. Mu për këtë arsye erdhi në Pakistan dhe e deklaroi Islamit e saj dhe e muar emrin Ajshe - emrin e nënës së besimtarëve.

Në rrugë për në Argjentinë, unë dhe nëna ime e kryem Umren, dhe me pas shkua në Xhevanë e cila ishte koloni franceze. Atje qëndruam gjatë muaj ku gjatë kësaj kohe u takova me një vajzë dhe u martova me të pasi ia shpejgova Islamit gjë që e pranoi edhe ajo në Qendrën Islamike të Argjentinës dhe e mori emrin Muine.

Ndërkaq, im at dhe familja e tij të cilët jetojnë në Remle (Palestinën e okupuar) më shkruajtën dhe më quajtën të çmendur!

A mendon që njeriu i devotshëm që nga fëmijëria e tij çoftë i krishterë apo çifut më shpejtë dhe më lehtë mund të arrijë deri të pranimit të Islamit se sa një njeri i cili nuk ka qëndrim fetar?

- Unë nuk jam ekspert për këtë çështje dhe nuk mund të gjykoj përveç se nga praktika. Ata të cilët e kanë pranuar fenë Islame nuk kanë qenë të krishterë apo çifutë.

Kush është musliman sipas mendimit tuaj?

- Musliman në kuptim gjuhësor është ai i cili i dorëzohet vetëm Allahut Një. Sipas mendimit tim musliman është ai i cili vetën e tij ia shet vetëm Allahut të Madhëruar, dhe i cili e di se çdo gjë është prej Allahut dhe tek Allahu kthehet.

Musliman është ai i cili i zbaton mësimet e Kur'anit dhe të Sunnetit.

A jeni mistik (mutesavvif)?

- Nuk mund të them se jam mistik. Ai i cili mëson mbi lulet dhe rregullimin e kopshteve tek një kopshtar nuk mund ta quajë vetën kopshtar, mirëpo, si do që të jetë mundohet që të jetë i tillë përmes punës së tij të zellshme në njohjen e luleve.

Meqenëse keni mësuar mbi dramaturgjinë dhe kinematografinë a mendoni se arti ka lidhje me fenë?

- Sikur të ishte arti tjetër çfarë është sot, do të mund të shpiente deri te njohja e Allahut dhe adhurimit të tij. Mirëpo, arti bashkëkohor është plotësisht në kundërshtim me këtë. Arti bashkëkohor është idhull i cili adhurohet, ndërsa artistët e kanë humbur ideologjinë e cila do ta bënte punën e tyre frytdhënëse. Arti i tyre nuk është art i vërtetë, sepse ka marrë rrugë të gabuar sa i përket kësaj bote ndërsa sa i përket botës tjetër - Ahiretit ata i pret një dënim i rëndë.

Çfarë është gjendja e muslimanëve në Amerikën Latine?

- Gjendja e muslimanëve në Amerikë ndryshonë nga ajo në Evropë. Ajo është larg dhe me vonesë arrijnë dituritë dhe librat fetare. Njerëzit atje nuk interesohen shumë për fenë. Muslimanët nga Islami nuk dinë tjetër pos shahadetit! Ndërkaq, njerëzit tjerë nuk dinë mbi Islamit veçse skena trishtuese dhe luftëra në mes shteteve Islame!!!

Si i sheh muslimanët sot?

- I shoh dy llojsh: Një lloj i tyre flasin për dispozitat e Kur'anit dhe Sunnetit dhe nuk punojnë sipas tyre! Dhe lloji dytë, të cilët punojnë atë që e thonë, i përmbahen Kur'anit dhe Sunnetit dhe zemrat e tyre janë të lidhura ngusht me urdhërat e Allahut xh.sh...

Çfarë janë dëshirat e tua për muslimanët?

- Dëshiroj që muslimanët të jenë Kur'an i cili ecën me dy këmbë.

Marrë nga revista "Err-Rrihab"

Përktheu nga gjuha arabe: Sadik Melumeti

Argumentet shkencore të shpalljes së Kur'anit

Sot në botë jetojnë mbi një miliardë muslimanë, të cilët pa kurrfarë luhatie besojnë se Kur'ani famëlartë është fjala e Zotit dhe se ajo është mrekulli e Zotit. Pse jo, kur edhe armiqët i bëjnë nderin e merituar kur është fjala për natyrën mrekulluese të këtij libri hyjnor. R. Bosworth Smith, i njohur në librin e tij "Muhamedi dhe Muhamedanizmi", për Kur'anin shprehet se është mrekulli e stilit të pastër, utësi dhe realitet. Një tjetër dije ar. A.J. Arberry, në parathënien e përkthimit të vet të Kur'anit thotë: Sa herë që e dëgjoj leximin e Kur'anit më duket se dëgjoj muzikë dhe sikur ajo melodi është përcjellë me të irahur të përhershëm të ledrave (veglave), dhe kjo, sikur po kërset zemra ime. Në bazë të këtyre fjalëve, si edhe e të tjerave nga parathënia e tij, cikush mund të mendonte se është musliman, por ai vdiq si i krishter.

Edhe një anglez tjetër, Marnadike Pickthall, në parathënien e përkthimit të Kur'anit e përshkruan si simfonitë të pakrahueshme, tingujt, e të cilit e prekin njeriun aq sa e mallëngjejnë dhe e magjepsin. Ky person e kishte pranuar fenë islame para se ta përkthente Kur'anin, por nuk mund ta konstatojmë një gjë: a e ndjenjtë në shpirt edhe më përpara apo tek pas kalimit në islam? Sidoqoftë miqtë dhe armiqët i shprehin respekt shpalljes së fundit të Zotit - Kur'anit famëlartë. Njerëzit që kanë jetuar në kohën e Muhamedit a.s., në bukurinë dhe madhësinë e Kur'anit kanë parë fisnikërinë e thirrjes dhe shpirtëgjërësinë e shpalljes, si argument dhe Mrekulli e Zotit, dhe pranuan fenë e vërtetë. Për të gjitha këto nderime dhe dëshmi mosbesimtare dhe personi i dyshimtë do të thotë se këto janë ndjenja të njëanshme dhe do të provojnë të japin njëfarë arsytimi se nuk e dinë gjuhën arabe. Unë nuk e shoh atë që e sheh ti, e as nuk e ndjej atë që e ndjen ti. Ku ti di unë se Zoti ekziston dhe se Ai ka inspiruar profetin e vet Muhamedin me atë shpallje të bukur, Kur'anin? Pastaj vazhdon: Unë nuk e mohoj bukurinë e filozofisë së tij, të moralit të lartë praktik. Unë jam i gatshëm të pranojë se Muhamedi ka qenë njeri i sinqertë dhe se ka dhënë shumë mësim dhe rregulla të bukura për të mirën e njeriut. Por atë që nuk mund ta pranojë është ajo se

ju muslimanët deklaroni se fjala është për nivel mbinatyror të urdhërave të tij.

Këtij mentaliteti simpatik por më të njëjtën kohë edhe skeptik, Autori i librit (Kur'anit) i ofron lloje të ndryshme argumentesh për t'i ç'rrenjosur dyshimet e atiestëve dhe atyre që dyshojnë, të cilët kanë diapazon të gjerë shkencor, dhe që konsiderohen "gjigantë intelektualë", u argumenton se ata në fakt janë sikur "shkrutabiq". Sikur një shkrutabiq i cili është zhvilluar shumë në një drejtim, por ka pësuar degjenerim gjetiu, e një degjenerim i tillë ka shtuar dyshimin. Krijuesi i gjithëfuqishëm e pyet...

Por para se t'i parashtrijmë pyetjet e Zotit, desha të shpreh kureshtjen time personale. Është njerëz të shkencës, të cilët e studiojnë astronominë dhe që hulumtoni gjithësinë tonë me anë të teleskopëve tuaj të fortë, sikur po hulumtoni ndonjë objekt në shuplakë të dorës suaj: më thoni si zuri fill bota? Ky shkencëtar edhe pse nuk ka të dhëna spirituale, prapëseprapë bujarisht do të na këshillojë, dhe me gatishmëri përgjigjet. Ai thotë: para miliarda e miliarda vjetësh bota jonë ishte një copë materie dhe atëherë ndodhi "eksplozimi i madh" në thelbin e asaj mase të madhe të materies, dhe copat e mëdha të materies filluan të fluturojnë në të gjitha anët. Nga ai "eksplozimi i madh" është krijuar sistemi diellor dhe galaksia dhe meqë në gjithësi nuk pat kush t'i bënte rezistencë asaj force lëvizëse praprake që zuri fill nga ai eksplozim i parë, yjtë dhe planetët notojnë në drejtimet e tyre. Bota jonë po rritet. Galaksia çdo ditë e më tepër po largohet prej nesh dhe kur arin shpejtësinë e dritës, ne nuk do të jemi në gjendje më të shohim. Duhet patjetër të bëjmë teleskopë më të mëdhenj e më të mirë që t'i studiojmë ato horizontet, në të kundërtën na iku treni.

Kur e keni zbuluar këtë përallë? - E pyesim ne. Jo, këto s'janë përalla, por janë fakte shkencore! - na thotë mikun ynë. Mirë, unë i pranojë këto shënime tuaja, por kur i keni zbuluar këto fakte? Jo fort moti! - na tha ai. Në historinë e njerëzimit pesëdhjetë vjet janë jo frot moti.

Një arab alfabet në shkretëtirë para 1400 nuk ka mundur të dijë për teorinë e eksplozimit të madh dhe rritjen e

gjithësisë, apo jo? - e pyesim. Jo, kurrsesi! - na përgjigjet ai me mburje. Pa dëgjoni pra, çka ka thënë ai sipas udhëzimit të Zotit:

"A nuk e shohin pabesimtarët se qiejt dhe toka kanë qenë të ngjitur, porse Ne i kemi ndarë ato (pjesë-pjesë)?..."

(El-Engjia: 30)

"Ai është i cili ka krijuar natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën. Të gjitha notojnë nën kupën e qiellit".

(El-Enbija: 33).

A nuk e shihni se këto fjalë ju drejtohen në mënyrë të veçantë juve shkencëtarëve: gjeografëve, astronomëve... të cilët pasi që keni zbuluar tërë këto gjëra të çuditshme, dhe ia keni dorëzuar njerëzimit, akoma po mbeteni aq të verbër dhe nuk shihni se kush është kreator i tyre?

Ne me shkencat dhe enciklopeditë tona shpesh harrojmë HYJNINË në këto laboratorime, thotë Thomas Crlyle. Si mund të jetë e mundur që një bari devesh në shkretëtirë të ketë mundësi të grumbullojë faktet tuaja para 1400 vjetësh, në mos i pastë marrë nga Krijuesi i eksplodimit të madh?

E ju biologë, që pretendoni ta njihni tërë jetën organike, a edhe ju keni guxim ta mohoni ekzistimin e burimit të asaj jete, do të thotë të Zotit? Më thuani ju lutem, sipas hulumtimeve tuaja, me çka po lavdëroheni aq shumë..., kur ka filluar jeta? Ndërsa ai, sikur edhe kolegu i tij i dijshtëm, astronomi ateist, filloi njëlloj - Pra para miliarda e miliarda vjetësh, materia esenciale në det ka filluar të prodhojë protoplazmën prej së cilës ka rrejtur ameba, e prej atij lloçi të detit janë zhvilluar të gjitha gjallesat. Me fjalë të tjera, tërë jeta rrjedh nga deti - nga uji.

Kur e keni gjetur atë argument se të gjitha gjallesat kanë prejardhje nga uji? E njëjta përgjigje, sikurse ajo e kolegut të tij astronom: Jo fort moti.

do të thotë para 14 shekujsh, kurfarë shkencëtar, as filozofi, e as poeti, kurrsesi nuk do t'ia qëllonte këtij zbulimi tuaj, apo jo? Edhe ky biologu ynë është i vendosur sikur edhe astronomi. Jo kurrsesi, tha. Eh, mirë pra, tani dëgjoni anal-fabetin e shkretëtirës:

"Dhe Ne nga uji krijojmë çdo gjë. A nuk besojnë?"

(El-Enbija: 30)

Duhet pra ta keni ndërmend se këto janë fjalë të Gjithëfuqishmit, Gjithëdijshtmit, Krijuesit të botës - gjithësisë, që u drejtohen juve shkencëtarëve, si përgjigje

për skepticizmin tuaj të sotëm, ndërsa domethënia e vërtetë e atyre fjalëve ka qenë e pakuptueshme për banorët e shkretëtirës para 14 shekujsh. Kreatori iu drejtohet juve shkencëtarëve, si bëhet ju të mos i besoni Zotit? Të paktën ju nuk guxoni ta mohoni ekzistimin e Tij, e pra jeni mui ata që veproni kështu! Çështje me ju? Madje dhe botanistët, zoologët dhe fizikantët, të cilët përkundër thellimeve të tyre ata, pra, të na i shpjegojnë këto fjalë të Kur'anit:

"I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet), nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë"

(Jasinë: 36).

Ajetet nga ky libër i Zotit vetvetin kuptohen. Ata që e studiojnë Kur'anin e shohin pjesëmarrjen e pagabueshme në secilin zbulim të ri që po bën njeriu. Ato janë faktet - mrekullitë nga Zoti i tij i gjithëmëshirshëm e mësharëplotë, për ta hequr dyshimin e njeriut dhe ta përforcojë fenë e vërtetë,

"...Këto janë njëmend argumente për njerëzit që dinë".

(Err-Rum: 22)

Çfarë ironie! Mu shkencëtarët janë ata të papërlurur që po mburren për dijeninë e madhe që kanë lidhur me çshtjet materiale. Ata nuk kanë përlulshmëri të vërtetë e të singertë të cilën duhet ta ketë njeriu, nëse posedon dije të vërtetë.

Enes Koshi Kl. IV-b

Llogaria

Asgjëja, vetja

Lindja, provokimi, vdekja

Ringjallja, shpërblimi-përgjegjësia

Askush nuk mund të ikë nga llogaria

Faruk Beqiri

(Student nga Vitia)

E vërteta për dukurinë e quajtur "gravitet"

"Ai e lëshon një (shiu) nga qielli e sipas madhësisë së tyre rrjedhin përroçka, kurse vaka bart mbi vete shkumë të fryer lart. Shkuma e ngjashme është edhe ajo kur shkrirhet (metali) në zjarrin për të fituar ndonjë stoli ose ndonjë uj. Kështu, Allahu sqaron shembullin e të vërtetës dhe të pavërtetës. Për sa i përket shkumës (së ujit apo të metaleve), ajo hidhet si mbeturinë, ndërsa ajo që u sjell dobi njerëzve, ajo mbetet në tokë Kësisoj Allahu i zjell shembullin".

(Surjea 13 (Er Ra'd), 17).

Njëri ndër argumentet që japin të kuptosh për fuqinë e pakufishme të Zotit krijues, është shiu kohë pas kohshëm, i cili i jep jetë çdo sendi e gjallesë. Prej shiu formohen ujërrjedhëse të mëdha ose të vogla dhe gjatë rrjedhjes së ujit me vrull, formohet një shkumë e cila qëndron mbi sipërfaqen e ujit dhe duket si një begati. Në të vërtetë, ajo është vetëm një mashtrim, pse pas pak kohe ajo, së bashku me mbeturinat skajohet buzëve të rrjedhës, e prej saj nuk ka kurrëfarë dobie. I dobishëm ishte uji, të cilin e thithi toka, formoi lagështi të cilën e ruan për ushqimin e bimëve. E pavërteta, e kota në këtë jetë duket se po rritet, po përparon, e në realitet ajo nuk është asgjë, s'ka dobi prej saj dhe zhduket shumë shpejtë. Ndërsa e vërteta është si uji që mbetet në tokë dhe ruhet për nevojën më të madhe.

Një problem që me shëkuq e ka preokupuar dhe munduar mendjen e njeriut, është të shpjeguarit e dukurisë fizike që në shkencë njihet me emrin "gravitet" apo "gravitacion". Ajo që në kohët e lashta deri në shekullin tonë është trajtuar si forcë tërheqëse në mes të trupave që kanë një furë mase dhe gjenden në një distancë të caktuar në mes veti.

Fjala "gravitet" rrjedh nga gjuha greke që në gjuhën tonë do të thotë forcë.

Shkencëtarët më eminentë të historisë njerëzore janë marrë me problemin e "gravitetit". Çdo njëri nga ata ka tentuar t'i plotësojë të metat e teorisë së më parshme për "gravitetin" duke e trajtuar atë si forcë tërheqëse në mes trupave.

Kështu, Isak Njutni (1642-1727), fizikan, astronom dhe matematikan anglez "gravitetin" e konsideron si forcë tër-

heqëse universale të cilës i nënshtrohet krejt kosmosi dhe intenziteti i të cilës është në përpjestim të drejtë me prodhimin në mes masave të trupave, dhe në përpjestim të zhdrejtë me katrorin e distancave në mes qendrave të tyre. Duke e bërë formulimin matematikë të ligjit, ai arriti famë të madhe në çarçet shkencore të kohës kur jetoi, famë e cila u ruajt deri në ditët tona.

Dukurinë e "gravitetit" si forcë tërheqëse në mes trupave e ka studjuar edhe shkencëtari më i njohur në botë, Albert Ajnshtajni (1879-1955). Ai pohon se egziston lidhmëri fundamentale në mes dukurive lëvizëse të nxitura dhe dukurisë së "gravitetit", sipas Ajnshtajnit, lëvizja e nxitur dhe fusha e "gravitetit" në mes vete janë dukuri plotësisht ekuivalente. Kjo në fakt paraqet përmbajtjen e parimit të Ajnshtajnit për ekuivalencë në mes të fushës së "gravitetit" dhe lëvizjes së nxitur. Këtë parim, Ajnshtajni, e merr si parim themelor për ndërtimin e teorisë së përgjithshme të relativitetit.

Pra, sipas Ajnshtajnit, gjithësia mund të ekzistojë edhe pa "gravitet" si forcë tërheqëse universale. Ajnshtajni, gjithashtu pohon se fusha e "gravitetit" mund të përcillet në sitanca të caktuara në formë valësh gravitacionale. Ky mundohet të shpjegojë edhe natyrën korpuskulare të fushës së gravitetit përmes grimcave që i quajnë gravitone. Mirëpo, eksperimentalisht deri sot nuk ka mundur të vërtetohet se fusha e "gravitetit" mund të përhapet në formë valësh, e as që është vërtetuar ekzistenca e gravitacionit.

Kështu, është e natyrshme të mendohet dhe të shtohet pyetja çfarë e pengon mosnjohjen e natyrës dhe vetive të fushës së "gravitetit", siç njihet fusha elektrike apo magnetike. Përgjigja do të ishte: Natyrisht shpejgim i gabuar i kësaj dukurie fizike e asgjë tjetër.

Pra, në esencë dukuria e njohur me emrin "gravitet" është kuptuar dhe shpjeguar në mënyrë të gabuar. Andaj, bota e saj, ka mbetur në terr edhe sot e kësaj dite.

Për të ndriçuar këtë problem, dhe për ta interpretuar ashtu si është realisht, duhet të mbështetemi në mrekullinë e Kur'anit Famëllor të cilat janë të panumërta në lëmenj të ndryshëm e veçanërisht në lëmin e fizikës, astrofizikës dhe astronomisë.

Kështu, shqyrtimin e problemit duhet ta fillojmë nga fakti kur'anor se gjithësisa është e ndërtuar prej shtat kateve (shtat sferave qiellore), në katin e parë të së cilës është e vendosur e tërë bota lëndore kalimi nga kati i parë në katët tjerë është i pamundur. Pra, kjo paraqet modelin e gjithësisë së mbyllur, e të cilin model më të drejtë e pranon edhe Ajnshtajni. Ky, gjithashtu me të drejtë, e pranon edhe formën sferike simetrike të hapësirës kozmike.

Problemin e simetrisë në pikëpamje gjeometrike mund ta kuptojmë kështu: çdo pikë e hapësirës e ka pikën simetrike të saj. Pra, këtu kemi të bëjmë me çiftin, i cili ceket në Kur'an kështu:

"Dhe Ai është, i cili tokën e shtriu, dhe në të krijoi kodra e lumenj dhe prej secilit frut bëri dy lloj (çift), bëri që nata ta mbulojë ditën. Vërtet, në të gjithë këtë ka fakte për njerëzit që thell mendojnë".

(Sureja 13 (Er Ra'd), 13).

Siç mund ta kuptojmë edhe materien dhe energjinë që janë të vendosura në hapësirën kozmike. Materja në kosmos është çdo herë në lëvizje dhe në transformimin të vazhdueshëm. Për këtë problem në Kur'an a.sh. thuhet:

"Allahu është ai që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë. Ju i shihni ato. Ai mbizotëroi Arshin dhe nënshtroi diellin e Hënën që çdo njeri udhëton deri në një afat të caktuar..."

(Surje 13 (Er Ra'd), 2).

"... dhe e ka nënshtuar Diellin dhe Hënën - secili lëviz deri në kohë të caktuar - ...".

(Sureja 31 (Lukman), 29).

"Edhe dielli udhëton për në kuftinë e vet (në cakun përfundimtar)..."

(Sureja 36 (Jasinë), 38).

Siç shihet nga këto versete kur'anore çdo trup në gjithësi është në lëvizje të përhershme dhe çdo njeri nga këta do të përfundojë me shkatërrim.

Është interesant të parashtrohet pyetja se cila dukuri fizike e mundëson këtë gjë që Allahu xh.sh. e cek në Kur'an. Pra kush është ajo dukuri që trupat që ekzistojnë në gjithësi i detyron të lëvizin dhe i çon kah shkatërrimi dhe në çfarë mënyre?

Përgjigjia më e saktë do të ishte: Askush tjetër, përveç dukuria që ne sot e njohim me emrin "fusha e gravitetit" apo "fusha e gravitacionit".

si mund të tregohet kjo?

Në këtë mënyrë: dukuria e quajtur "gravitet", në esencë nuk është forcë tërheqëse, siç ka menduar, e cila i detyron të lëvizin trupat kah qendra e Tokës, Dielli apo ndonjë trup tjetër, por është arma të cilën Allahu xh.sh. i ka dhuruar

materjes (substancës) për ta mbrojtur formën e vet që ia jep pamjen më të bukur - formën sferike - simetrike.

Pra, kur ka pasur nevojë materja për këtë "armë"?

Vetëm atëherë ku i është prishur forma sferike - simetrike.

E kur i është prishur forma sferike - simetrike?

Në çastin (momentin) kohor kur materja në gjendje të "praatomit" është bashkuar me energjinë dhe ka ndodhur eksplodimi i madh. Kështu, materja në gjendje të "praatomit" ka qenë e koncentruar në një trup të vetëm në formë rruzulli të mbyllur, në të cilin nuk ka pasur kurrëfarë energjie. Kështu, duke mos pasur nevojë trupi i këtillë për armë e vet, e ka humbur atë. Në këtë moment, ky trup duke qenë i pa mbrojtur, është "sulmuar" nga energjia dhe ka ardhur deri te eksplodimi i madh, gjatë të cilit është shkatërruar i tëri dhe është shndërruar në formë pluhuri, çdo grimcë e të cilit ka pasur energji. Kështu ka humbur forma sferike - simetrike e materjes. Çdo grimcë ia ka krijuar fusha e "gravitetit", me qëllim të kthimit në gjendje të mëparshme (gjendje "praatomit"), dhe kështu ka filluar lëvizja e grimcave. Me kalimin e kohës duke u bashkuar grimcat janë krijuar trupa të përmasave të ndryshme, të formës përafërsisht sferike në qendër të të cilëve janë grimca në gjendje "praatomit". Pra, të gjitha trupat qiellore në qendër të tyre kanë nga një trup në gjendje "praatomit" të rrethuar me fushë të fortë të "gravitetit". Me rritjen e trupit në gjendje "praatomit" rritet dhe intensiteti i fushës së "gravitetit" dhe si pasojë e kësaj rritet emitimi i energjisë nga trupi, e kjo përcillet me rritjen e temperaturës së sipërfaqes së jashtme.

Kështu, toka në bërthamën e saj ka një temperaturë të lartë, e krejt kjo është si pasojë e intensitetit të madh të fushës së gravitetit në afërsi të qendrës. Mu në qendër të tokës ekziston materja në gjendje "praatomit", e cila në vetvete nuk ka as energji e as fushë të "gravitetit". Por, ajo është e rrethuar me fushë të gravitetit e cila vazhdimisht rrit intensitetin dhe materjen e tokës e shndërron në gjendje "praatomit" duke ia larguar energjinë. Kështu duke u liru vazhdimisht energjia, si pasojë e rritjes së intensitetit të fushës së "gravitetit", tokës në qendër i rrit materja në gjendje të "praatomit", i shtohet temperaturara në sipërfaqe të jashtme dhe i zvogëlohet vëllimi vazhdimisht.

Përshkrimin e këtij problemi e hasim në Kapitullin Ra'd në këtë mënyrë:

"A nuk po shohin ata, që Ne po u shkatërrojnë tokën (mohuesve) duke i zvogëluar skajet e saj..."

(Sureja 13 (Ra'd), 41).

Në bazë të kësaj logjike, me rritjen e vazhdueshme të temperaturës në sipërfaqe të tokës (e cila zgjat një periudhë të gjatë kohore krahasuar me jetën tonë), dhe të intensitetit të fushës së "gravitetit" të saj, do të vijë deri të një termi i madh, për të cilin Allahu xh.sh. bën fjalë në Kur'an kështu:

"Kur Toka të dridhet me dridhjen e tmerrshme të saj, dhe kur ajo (Toka) të nxjerrë materiale nga brendia e saj..."

(Sureja 99 (El-zilzal), 12).

ose

"në Ditën kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër..."

(Sureja 14 (Ibrahim), 48).

Si përmbyllje mund të themi se dukurisë e cila në botën shkencore njihet me emrin "gravitet", qysh herët iu ka veshur gabimisht petku me emrin "forcë tërheqëse", dhe si e tillë ka mbetur në terr ndriqimi i plotë i saj do të ishte vetëm atëherë kur kësaj dukurie ia përshkruajmë rolin e famshëm që ka - pra është "armë" me të cilën materia e ruan formën e vet sferike - simetrike, ajo materies ia "ndjek" energjinë dhe kështu e kthen në gjendje të "praatomit".

Gjatë kësaj "ndjekjeje" kemi vazhdimisht qarkullim të energjisë dhe lëvizje të trupave.

Shikuar në këtë aspekt, Ajnshtajni aspak nuk ka të drejtë kur e vendos ekuivalencën në mes dukurisë së "gravitetit" dhe lëvizjes së nxitur.

Materia do ta ketë fushën e "gravitetit" deri sa e tëra të mos bashkohet dhe të kthehet në gjendje të "praatomit", pra, atëherë kur të bëhet një trup i vetëm dhe të marrë formë më të bukur - forma sferike - simetrike. Atëherë në mbrendi as sipërfaqe të trupit të kësaj nuk do të ketë energji. Energjia do të mbushë hapësirën jashtë tij. Trupi i krijuar, në këtë moment nuk do të ketë më nevojë për fushë të "gravitetit" dhe kjo si e tillë do të humbet.

Në fund, duke pasur çdo herë në mendje fjalët e Kur'anit të madhëruar, zemra dhe shpirti marrin entuziazëm, duke i dhënë hov gjuhës për ta lavdëruar dhe lartëmadhëruar Allahun e Gjithfuqishëm dhe të Gjithëdhjshëm me fjalët "Tete barekell - Ilahu ahseul halikin" (I Lartëmadhëruar qoftë Allahu më i bukur i Krijues).

Lasim Allahu xh.sh. që dukurisë që ia ka dhënë një rol aq të rëndësishëm në gjithësi me ndihmën e Tij, t'i hiqet ajo çka i është investuar deri më tani (forcë tërheqëse me emrin "gravitet") e që e ka bërë të panjohur për mendjen e njeriut, t'i përshkruhet ajo që e ka në rolin që luan, ta njohë dhe studiojë mendjen e njeriut e njëkohësisht të mirat e saj t'i përdorë për të bërë një jetë sa më të lumtur.

Pamir M. Shatri

Mendime të arta të Hasan Basriut

Hasani na mëson: "Katër persona janë të cilët më kanë mungësuar (mishnitar): një pijanec, një femijë dhe një grua.

1. Një ditë e takova një mekatar dhe e çortova ashpër. Ai më tha: O sheh, mos mallko ashtu, sepse fundi i jetës tënde dhe jetës sime është i panjohur. Vetëm Allahu e di se si do të përfundojë jeta jote poashtu dhe e imja. A nuk është e mundur që unë të shpëtohem me pendime të sinqerta, e ti të rrezohesh për shkak të mendjelatësisë dhe krenarisë sate?"

2. Gjithashtu e kam parë një pijanec se si po ngritej prej baltës me ç'rast i thashë: "Forcoi hapat tuaj o i mjere! Në mënyrë që mos të rrezohesh përsëri!" Kurse ai ma ktheu: "ai ke forcuar ti me autoritetin tënd këmbët tua!" Nëse unë rrezohem, është rrezuar një pijanec dhe unë më në fund edhe mua! të ngritem, por ti duhet të kesh kujdes që të mos

rrezohesh, sepse nëse ti do të rrezohesh, do të rrezoheshin me ty mijëra të tjerë!"

3. E takova një femijë i cili në dorë e mbante një qiri të ndezur. E pyeta: Më thuaj, o biri im, prej kah vjen kyodritë? ai e fiku qirin dhe tha: "Kur ti të më thuash ku shkon drita, unë do të them prej kah ka ardhur!"

4. Njëherë më erdhi një grua shumë e bukur, me fytyrë dhe duar të zhujuara, dhe m'u ankua për bashkëshortin që e kishte lënë. "Së pari mbuloje fytyrën tënde, e pastaj fol!" I thashë. Ajo në këtë tha: "O Sheh, unë jam e debur me dashuri ndaj një njeriu dhe sytë e mi e shohin vetëm atë. Ti pohoj se e do Allahun, e si, pra po e sheh fytyrën time?!"

Adnan Pollgo kl. IV-a

Definimi i synetit dhe bidatit

Është detyrë dhe obligim fear për çdo musliman që t'i njehë karakteristikat e synetit dhe bidatit.

Është e ditur se synnet - gjuhësisht domethënë rrugë, ndërkaj në terminologjinë fetare kuptojmë rrugën të cilën e shpjegoi dhe e komentoi Muhamedi a.s., librin e Zotit me fjalë, vepra dhe me miratime. Ndërkaj çdo gjë jashtë kësaj rruge është bidat. Pra me bidat nënkuptojmë shpifje të pashembullt më parë. E gjejmë edhe te fjala e All-llahut ku thotë:

"Shpikës i qiejve dhe i tokës, icili është fillestar, i pashembullt më parë, i qiejve dhe tokës, çka nuk i përket askujt tjetër përveç All-llahut xh.sh. Vetëm ai është i gjithëfuglshëm të krijojë çka të dojë dhe vetëm ai e ka ligjësuar fenë".

I madhërisht thotë: *"Juve ju ligjësova nga feja atë që ia rekomandoi Nuhit a.s."* (Shura 13) Ndërsa në shariatin Islam me "bidat": kuptojmë shpifje në fe pas përkryerjes së saj domethënë pas Muhamedit dhe hulefairsashidinëve.

Pra çdo veprimtari e shpikur që nuk gjen mbështetje (argument) në shariatin islam quhet bidat.

Bidatet i ndajmë në dy grupe: fetare dhe jetësore.

Sa u përket bidateve në fe ato janë rreptësisht të ndaluara.

Pejgamberi a.s. thotë: rusju nga bidatet se çdo bidat është humbje! Ky hadith është prej shtyllave bazë të kësaj feje e i përngjan fjalës së Muhamedit a.s.:

Kush shpik diçka të re në fenë tonë e që nuk është prej zotit është e refuzuar. (Muslimi). Ky hadith është një rregull i madh prej rregullave islame, është prej fjalëve pëmbledhëse të Muhamedit a.s., ky hadith është i qartë dhe argument për kundërshtimin e çdo risie në fe qoftë e shpikur tani ose më herët, p.sh. lutje në teqe dhe kërkim ndërmjetësim në ibadet nga të vdekurit.

Ndërsa sa u përket bidateve (risive) të jetës ato nuk paraqesin kurrfarë problemi, por janë të nevojshme dhe nuk e dëmtojnë fenë.

Për këtë argument hadithi të cilin e transmeton Muslimi në fund të së cilit thuhet: "Vërtet unë jam njeri, nëse ju udhëzoj diçka në çështje të fesë suaj pranojeni, e nëse ju udhëzoj diçka nga mendimi im, pranojeni me rezerve (sepse unë jam njeri dhe mund të gaboj) si p.sh. udhëtimi i Pejgamberit a.s. me deve, kurse sot udhëtojmë me makina të ndryshme. Ky pra është dallimi në mes bidateve fetare dhe jetësore. Mirëpo tash shtrihet pyetja se a ka bidat të mirë në fe? Në fe nuk ka risi të mirë sepse Allahu xh.sh. thotë:

"Sot ua përsosa fenë tuaj dhe ua kam plotësuar dhuunitë e Mia dhe Jam i kënaqur që islami të jetë feja juaj".

Ajo që atëherë nuk ishte fetare nuk është as sot. Imam Maliku r.a. thotë: Kush e shpik një bidat në fenë islame duke menduar se është e mirë ai me atë rast mendon se Muhamedi a.s. e tradhtoi pejgamberllëkun. I dërguari i Allahut thotë: Kush shpik diçka të re në fenë tonë, e që nuk është prej saj është e refuzuar", d.m.th. tregim ndaj Muhamedit a.s. kinse feja e tij është e mangët dhe kinse bidatgjiu e plotësoi me bidatet e veta.

Pejgamberi a.s. thotë: Ua lash juve dy gjëra, s'keni për të humbur nëse kapeni për to - Librin e Allahut dhe synetin tim

Transmetohet në librin "El-muvetta" nga Maliku r.a. se pas vdekjes së Muhammedit a.s. feja që përsosur dhe plotësuar tërësisht, kurse ne duhet pasur gjurmët e të dërguarit të Zotit. Komunikohet nga Aisbeja r.a. se: *"Kush e përkrak bidatgjim i ka ndihmuar mposhtjes së islamit".*

Hudhejfeja r.a. thotë: *"Çdo bidat është humbje edhe pse e shohin njerëzit si të mirë".* Pra ai cili shpif bidate e që është normal, nuk ka besuar në fjalën e Allahut xh.sh. *"Sot ua përsosa fenë tuaj..."*. Pra dashuria ndaj Pejgamberit a.s. nuk shprehet me bidate, por duke e ndjekur rrugën e tij, siç thotë edhe Allahu xh.sh.:

"Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë" (Ali Imran 32)

Kurse me ringjallje të sunnetit kuptojmë zhdukjen, asgjësimin e bidateve dhe anasjelltas. Siç thotë edhe ibni Sirini: Ardhja e një bidati shkakton humbjen - asgjësimin e një sunneti.

Pra bidati nuk është gjë tjetër përveç se disponim i atyre që ndiejnë nevojë për të dhe i konsiderojnë veprat e tyre më të vlefshme se të tjerëve. Gjithashtu këta njerëz nuk mendojnë në fjalën e Allahut xh.sh. ku thotë: *"Thuaj: A t'ju tregoj se veprat e kujt janë të shkatërruara? Mundi i kujt është i dështuar në këtë botë, e ata mendojnë se është mirë atë që punojnë"*. (Kelf 103-104).

Dhe në fund hadithi i Pejgamberit a.s. ku thotë: Kush do të jetë pas meje do të shoh kundërtbënie drejtimesh të ndryshme. Pra për ju është obligim t'i pëmbaheni sunetit tim (rrugës sime) dhe sunetit të Hulefai Rashidinëve. Pasojeni rrugën time, shtrëngojeni me dhëmballë (fort). Rrugjuni nga gjërat e shpifura të drejtimit të trilluara, sepse çdo shpifje është bidat, e çdo bidat është humbje, kurse çdo humbje të shpie në zjarr. (Davudi - Nesaiu e të tjerë)

Blerim Krasniqi IV-a

Kush ishte Abdullah Iben Mesudi

Për këtë sahabi të njohur ka thënë Muhammedi a.s.: "Kush dëshiron të dëgjojë Kur'anin ashtu si është zbritur, le ta dëgjojë nga Ummi Abdi".

Ishte nga fisi "Beni Hudhejli" dhe është rritur në një familje të varfër. Pas vdekjes së babait u detyrua të shkojë në Meke për të siguruar jetën, ku edhe filloi të punojë si çoban (bari) te Ukbe ibën Muii. Kaloi një pjesë të jetës si bari derisa i erdhi vahji Pejgamberit a.s. dhe pranoi islamit prej të parëve. Një ditë papritmas tërë Mekën e zgjoi zëri i të vërtetës islame, filloi riprezentimi i fesë islame nga njeriu me vyrtyte shumë ta larta i cili do të jetë shpëtues për njerëzimin dhe i cili do të jetë shembulltëri e paharruar deri në shkatërrimin definitiv të botës. Se si u entuziazma për pranimin e islamit ai nëfen: një ditë derisa po i rruja delet, pramë meje kaluan dy njerëz të panjohur. Njëri prej tyre m'u afroa dhe më kërkoi pak qumësht. Unë i thashë: Si të jepi qumësht kur delet nuk janë të mizat! Më falni, s'po na këto dele i kam në emanet. Ai më tha: më afro një dele që nuk ka qumësht, që nuk mbarësohet dhe nuk lind. Unë ia afrova një dele, e ai filloi t'ia lëmojë gjinjë, e në ndërkohë peshpëriste diçka në vetvete. Menjëherë ia mbushën gjinjë me qumësht. Ai njeri i bukur më ofroi së pari mua të pijë qumësht, pastaj pinë ata dy prapë diçka përsëriti në vetvete dhe delja u kthye në pozitën e mëparshme. Ky njeri kishte qenë Muhamedi a.s., kurse ai tjetri Ebu Bekri. U larguan që të dy, por unë mbeta i hutuar duke thënë: Çfarë mrekullie! Qumësht aq të ëmbël nuk kisha shijuar kurrë. Shumë i mahnuar dhe i befusuar fillova t'ia kërkoj ata dy njerëz derisa i gjeta. E gjeta atë më të bukurin që e quanis Muhamed. Ai më shpjegoi misionin e tij islam dhe me atë rast u bëra musliman, kurse Muhamedi a.s. më tha: ti djalosh do të bëhesh mësonës. Prej kësaj dite Abdullahu hyri në islam dhe tërë kohën thujasë ishte me Pejgamberin a.s., sa që njëherë ai i tha: se në mes ne të dyve nuk ka perde".

Ai e shoqëronte dhe kishte respekt të madh ndaj tij, sa që shumë njerëz mendonin se janë të afërt familjarisht.

Ishte hafiz i Kur'anit dhe ka qenë nga ata që e kanë shikuar Kur'anin gjatë shpalljes, nëpër guë. Ai thotë se 70 kaptina të Kur'anit i ka mësuar nga vetë goja e Pejgamberit a.s..

Edhe vetë Muhamedi a.s. kishte dëshirë të dëgjojë Kur'an nga goja e tij ku një ditë edhe i tha: lexo ma mua një pjesë nga Kur'ani, o Abdullah. Abdullahu i tha: Si të lexoj ty, kur ai të ka zbritur ty, o i dërguar i Allahut! Muhamedi a.s. i tha: "Unë kam dëshirë të dëgjoj nga tjetër kush". Abdullah ibni mesudi filloi të lexojë në surën "Nisa" dhe kur e lexoi ajetin 41 në të cilin thuhet: "Deh si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitar mbi ata (që nuk të besuan)" Muhamedit a.s. i pikën sytë lotë dhe tha: Te humbë o ibni mesud.

Gjithashtu, Abdullahu është i pari i cili na lexoi kurejshëve Kur'anin, haptas. Një ditë sahabet u tubuan te Pejgamberi dhe thanë, se si bëhet që edhe nuk po na lexojnë kurejshëve

Kur'anin haptas. Ata thanë se a ka ndonjë vullnetar që do t'ua lexojë? U kishmura i vetri Abdullah ibën Mesudi, por sahabet në fillim nuk pranuan sepse ishin të sigurtë, se kurejshët nuk do të trinin durim, dhe se ky ishte nga një familje e varfër dhe jautoritative. Sidoqë të jetë ai tha se do të më mbrojë Allahu xhsh. dhe doli. Në pranë e kurejshëve filloi të lexojë në surë "El-Rahman". Ata në fillim e dëgjuan derisa e morën vesh se atë që po ua lexon ai, është ajo që po i shpallëj Muhamedit të birit të Allahut. Ata pa pritje gjë e ruhën ibën Mesudin derisa e përgjakën. U kthye te shokët ashtu i përgjakur dhe ata i thanë se kësaj ia kemi frikuar, mirëpo ibni Mesudi ishte i vendosur, dhe thoshte se nëse duhet edhe nesër do t'ua lexoj.

Sa ishte bari te Ukbe ibni Muii, Ebu Xhehli njëherë ia afron dhe i ka rënë shuplakë, kurse ibën Mesudi në atë rast thotë se e kam pështyer në fytyrë dhe ai nga hut i kishte thënë: Nuk do të fali këtë, o çoban. Mirëpo si shihet Abdullahu ishte trim, dhe ai kthen duke i thënë: Se nuk do të shpëtosh kurrë o amrik i Zotit.

Kështu edhe doli sepse në luftën e Bedrit armiku më i madh i islamit Ebu Xhehli, u vra nga duart e Abdullah ibën Mesudit.

Pas vdekjes së Pejgamberit a.s. ka transmetuar hadithet, por thotë se kam qenë shumë i kujdesshëm në transmetimin e tyre. Në kohën e Omerit r.a., Halifi e dërgoi si mësonës në Kufë dhe letërën që u dërgoi atyre tha: "E kam caktuar Amar ibni Jasrin si guvernator tuajin, e me te edhe Abdullah ibën Mesudin si ministër dhe mësonës tuajin. Këta dy janë shokë të njohur të Muhamedit a.s. dhe ju urdhëroj të jeni të dëgjueshëm ndaj tyre. E për Abdullahun thotë se e zgjedha atë që e kisha zgjedhur për vete. Pranone për vali dhe mësoni prej tij".

Mirëpo kur erdhi në pushtet Othmani r.a. e shikoi nga detyra. Populli i Kufës u habit me vendimin e Halifes dhe e lutu ibën Mesudin që të trijë, mirëpo ai e respektonte Halifin dhe e pranoi vendimin e tij pa hamendje. Derisa ishte i sëmurë e kishte vizituar Othmani r.a. dhe i kishte thënë, se mos dëshiron diçka: Po, thotë Abdullahu, kam nevojë për mëshirën e të Madhit zot, Othmani i tha: a dëshiron ndonjë gjë. Ai tha: Më shëron Ai që më ka sëmurë. A dëshiron që t'ua jap pasuri bijave tua? Ibën Mesudi refuzoi dhe i tha Othmanit r.a.: a frikohesh se bijat e mia do të varfërohen?! Pastaj shtoi duke thënë: I kam urdhëruar të lexojnë surën "El-Vakia" Për çdo natë sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

"Kush e lexon çdo natë surën "El-Vakia", nuk do të godet kurrë varfëria". Abdullahu ibni Mesudi ka thënë:

Pasurimi më i mirë është pasurimi i shpirtit, kurse pasuria më e mirë është "takvallëku". Verërimi më i keq është verërimi i zemrës. Mëkati më i madh është rrena. Fidi më i keq është kamata. Ushqimi më i keq është malli i jetimit... e të tjerë.

Përgatiti:

Adnan Sogajeva kl II

Mëshira e Allahut xh.sh.

Thuaj: O robërit e Mi të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtet, Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që shpall fal dhe është mëshirues. (Ez-zymer 53)

Allahu meriton çdo falënderim ngase është bëmërisë, bujar i dhembshëm dhe i mëshirshëm pa masë ndaj krijesave të Tij. Mëshira e Zotit e ka mbuluar çdo gjë, ndërsa hidhërimi dhe ndëshkimi i Tij janë si masë përmirësuese e miratimit e jo hakmarrës. Zoti është i gjithmëshirshëm dhe bëmërisë i përgjithshëm ndaj të gjitha krijesave në botë. Ai është krijues dhe furnizues i nevojave të tyre ekzistencionale, shëndet, fëmijë, pasuri, pozitë etj i dhuron besimtarit e jobesimtarit, të mirit dhe të keqit, në bazë të mundit, përpjekjes dhe punës së tyre. Allahu është mëshirues dhe falës i mëkateve, në këtë botë dhe në botën tjetër vetëm ndaj tyre që kanë besuar ashtu siç ka urdhëruar Zoti nëpërmes pejgamberëve të Tij.

Muhamedi a.s. me një hadith thotë: Zoti i madhërueshëm mëshirën e vet e ka ndarë në njëqind pjesë. Nëntëdhjetë e nëntë i ka ndalur për t'i mëshiruar besimtarët në jetën tjetër, ndërsa një pjesë e ka zbritur në tokë, nga e cila mëshirohen krijesat mes veti, sa që edhe shtaza e tërheq këmbën nga viji i saj, duke pas frikë se po e shkel atë.

Mëshira e Zotit xh.sh. në këtë botë është e kushtëzuar me veprat dhe sjelljet tona, ndërsa në jetën tjetër me besim të vërtetë. Nëse kemi dhembje dhe i ndihmojmë njëri tjetrit, atëherë edhe Zoti do të jetë i mëshirshëm ndaj nesh dhe do të na dhurojë kënaqësi dhe lumturi në jetë. Në të kundërtën, atëherë si pasojë e veprave dhe sjelljeve tona negative, mund të vijë në shprehje hidhërimi i Allahut xh.sh. dhe masë e ndryshme ndëshkuese. Zoti xh.sh. me një ajet kuranor thotë: *Vërtet mëshira e Zotit është afër besimtarëve*. Ndërsa Muhamedi a.s. ka thënë: *"ai që nuk mëshiron, nuk do të jetë i mëshiruar"*.

Njerin duhet të jetë optimist dhe të shpresojë në mëshirën dhe faljen e Zotit xh.sh., por njëkohësisht duhet pasur frikë edhe hidhërimin dhe ndëshkimin e Tij. Përkundrazi me këtë Ai e ka porositur Muhamedin a.s. në Kur'an me këto fjalë: *"Lajmëroi robërit e mi (njerëzit) se me të vërtetë unë jam falës (i mëkateve) e i mëshirshëm, por edhe ndëshkimi im është ndëshkimi i pikëllueshëm"*.

Është fakt i pamohueshëm se sipas ligjeve të Zotit, njerëzit edhe në këtë botë, i përcjell shpërblimi ose ndëshkimi nga pasojat e veprave të tyre, por kjo është minimale dhe shërben për nxitjen e tyre në punë të mira dhe si tërheqje e të vërtetës që të rrihen nga veprat e këqija. Muhamedi a.s. ka thënë: *"Pasi e ka krijuar All-llahu botën, ka caktuar që nbi Arshin e Tij të jenë të shkruara këto fjalë: "Me të vërtetë, mëshira ime i paraprin hidhërimin Tim"*.

Në këtë hadisi-kudsijj përmenden fjalët e të Lartmadhëruarit Allah: *"O biri i Ademit, sa herë që më thirrë e të*

më lutë do të falia mëkatin e bërë tëndin, e nuk do të marrë në konsideratë (madhësinë e gabimit).

O biri i Ademit, sikur mëkatet tua të arrijnë lartësinë e qiellit (nga madhësia), e ti të më ke lutur që t'i falë, Unë t'i fal. Kush më takon me mëkatet të mëdha sa toka, e duke mos më shqëruar këud, Unë do ta presë (takoj) atë me po aq madhësi falëse.

All-llahu xh.sh. thotë: "E kur robërit e mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet". (Bekare: 186)

Muhamedi a.s. thotë se All-llahu i Lartmadhëruar ka thënë: *"Një rob bën një mëkat dhe thotë: All-llahu im, falma mëkatin tim! E All-llahu atëherë thotë: Robi im ka bërë mëkat, por e di se ka All-llah i cili ia fal mëkatet dhe i cili ndëshkon për mëkatet. E pastaj robi e përserit mëkatin dhe thotë: "All-llahu im, falma mëkatin tim!" Atëherë All-llahu i Lartmadhëruar thotë: "Robi im ka bërë mëkatet, e di se ka Zot, i cili i fal mëkatet dhe i cili dënon për mëkatet. Robi për të tretën herë e përsërit mëkatin, dhe propë thotë: "O All-llahu im, falma mëkatin tim!" Atëherë All-llahu thotë: Robi im ka bërë mëkat, por e di se ka Zot i cili fal mëkatet dhe dënon për mëkatet. Unë tashmë e kam falur robin tim, dhe tash le të bëjë ç'të dojë."*

Muhamedi a.s. ka thënë: *"Nuk do t'i ngjajë asnjë muslimani as dhembje, as brengë, as pikëllim, e madje as dhembje nga tjerja e një gjembi që të mos ia falë All-llahu mëkatin për këtë"*.

Muhamedi a.s. thotë se All-llahu i Lartmadhëruar ka thënë: *"Nëse robi im vendos të bëjë një veprë të mirë dhe atë nuk e bën, do t'i shkruaj një sevab dhe, nëse e bën, do t'ia shkruajë prej dhjetë deri në njëqind sevabe. E nëse mendon të bëjë një veprë të keqe dhe këtë nuk e bën, për këtë nuk i shkruaj mëkat, e nëse e bën, do t'i shkruaj vetëm një mëkat"*.

Hazreti Omeri transmeton: "Janë sjellë disa robër para Pejgamberit të All-llahut, kur një grup e zënë rob vrapoi në mes të të zënve dhe nisi të kërkonte diçkat. Kur gjeli një fëmijë të vogël, e mori, e vuri në prehër dhe filloi t'i jepte gjë. Pejgamberi i All-llahut, tha: "A po e shikoni këtë grup, a do ta hidhte në zjarr fëmijën e vet? As habet thënë: jo, pusha All-llahu. Atëherë Pejgamberi i All-llahut tha: "All-llahu është më i mëshirshëm për robërit e Tij se sa kjo nënë për fëmijën e vet".

Muhamedi a.s. thotë se All-llahu i Lartmadhëruar ka thënë: *"O biri i Ademit, derisa të më bësh lutje dhe të mbështetesh e të shpresosh në Mua, do t'i fal mëkatet që ka. O biri i Ademit, edhe sikur mëkatet e tua të jenë deri në qiell, po të më lutesh për falje, do t'i fal. O biri i Ademit, nëse do të mbushësh Tokën me mëkatet, por do të më drejtoshesh Mua dhe nuk do të më bësh shok, Unë do t'i fal."*

Fatmir Latifaj kl. II.

O ithtarë të librit ejani të bashkohemi

Hyrje

Historia na mëson se gjatë periudhave të ndryshme kohore kanë lindur edhe ideologji të ndryshme. Koha parahistorike karakterizohet me lindjen e besimeve të kota dhe largimin e njerëzve nga rruget e drejte. Përkundrazi këshillave të pejgamberëve të cilët shpeshherë mbyteshin, njerëzia nuk u kthye në rrugën e drejtë.

Në Lindjen e Afër në Palestinë, lajmërohet një pejgamber i Zotit me emrin Isa a.s. apo Jezusi nga Nazareti. Ithtarët e Tij sot njihen me emrin të krishterë. Por nuk do të thotë se të krishterët janë përmbajtja me përpikëri profetit të tyre Jezu Krishtit dhe librit të tij Unxhillit (Inxhillit). Përkundrazi ata e shtrëmbëruan atë (Unxhillin ndërsa profetin e tyre prej qenies së tij njerëzore e ngritën në piedestalin e hyjnisë së amshuar. Ata gjithashtu shpikën idenë e gabimit fatal të kryqëzimit, duke i shtuar kësaj ideje edhe shumë të pavërteta e absurditete tjera.

Krishtërimi në fillim ishte monoteizëm por kur depërtoi te një mbret gjysëm-pagan (Konstatimi i madh) ai u shndërrua në Trini.

Atëherë u paraqitën qindra ungjijë që quheshin Libra të Zotit. Ato ishin të shkruara sipas shijes së autorëve të tyre. Në botën krishtere sot pranoen vetëm katër prej tyre: Unxhilli i Mateut, Markut, Lukes dhe Gjoni.

Qysh prej shfaqjes së tij krishtërimi u nda në sekte. Në vitin 1054 u bë ndarja e Kishave, në Atë të Lindjes-kisha ortodokse dhe të Perëndimit - kisha katolike. Në vitin 1529 u lajmëruan edhe protestantët të cilët nuk qëndruan të njësuar por u ndanë në sekte.

Sot, në botën islame ka me mijëra misionare sektesh të ndryshme të krishterë, qëllimi i të cilëve është shkatërrimi i popujve muslimanë. Për t'i hedhur poshtë mësimet e tyre duhet të argumentojmë se Libri i tyre (Bibla) është vepër e dorës së njeriut dhe se Kur'ani - Shpallja e Muhamedit a.s është hyjnor. Për këtë do të na ndihmojë edhe All-Ihlu xh.sh.

"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet tona në horizonte dhe në votën e tyre deri sa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" Kur'an 41:53.

Tu bëjmë thirrje të gjithë atyre që nuk e kanë kuptuar drejtë Islamën, të lexojnë dy fundamentet e saja Kur'ani - librin e All-Ihlu xh.sh. dhe Hadithin - fjalët e të Derguarit, Muhamedit a.s. Vetë do ta vërtetojnë se Dini Islam është udhërrëfuesi në i mirë për të dy botërat.

Kapitulli i parë Tërrat dhe Inxhilli për Muhamedin

"Koha për nënshkrimin e vërtetë ndaj Perëndisë".

Ky është një nga titujt e broshurave të shumta propaganduese të Dëshmitarëve të Jehevait. Këto janë ndër misionarët më të përhapur në botë.

Propaganda e tyre është shumë e fortë. Revista e tyre "Kulla e Rojës" botohet në më se 120 gjuhë e natyrisht edhe në gjuhën shqipe. Kanë edhe revistën tjetër "AVVAKE"

(zgjohani) që botohet në 64 gjuhë. Tirazhet mesatare të tyre janë 16 milion, përkatesisht 13 milion ekzemplarë.

Kur e kemi fjalën te broshura e katërpërmendur, ajo është e maskuar aq mirë sa që një njeri i cili nuk ka njohuri të dëbur për fe të islame, lehtë do të helmozet. Kjo broshurë ka kopërtinë të gjelbërta, dhe në shikim të parë, duket sikur një broshurë islame.

Në vazhdim do të lexojmë pak nga kjo broshurë dhe t'i shqarojmë disa çështje që autorët e saj, i kanë shkruar gabimisht ose thënë shkurt: "e vërteta të dalë në shesh".

Ithtarët e Librit 1 e mohojnë të Dërguarin

Në "Koha për nënshkrimin e vërtetë ndaj Perëndisë" lexojmë: "Për shembull, stërgjyshëve të hebrenjve të sotëm modernë, atyre që jetuan në kohën e tij, Moisiu u tha: "Pikërisht nga gjiri yt, nga vëllëzërit tuaj Jehovai, Perëndia yt, do të nxjerrë për ty një profet si unë-atë dëndhet ta dëgjoni". (Ligji i përtëritë 18:15).

Kur erdhi ky profet?

Së pari, duhet të konstatojmë se në broshurë është përdorur përkthimi jehovist3 i Biblës (Nevv Vvord-Bota e re). Së dyti, përkthimet e Biblës nga ana e sektashëve (evangelistët, jehovistët etj) nuk janë identike me përkthimet më të vjetra sepse janë bërë mjaft përmirësime. Për këtë do të flasim më poshtë.

Shtrohet pyetja: Për çfarë qëllimi autorët e përmendin pikërisht këtë varg? Përgjigjja është e thjeshtë. Me këtë profeci4 mendojnë të argumentojnë ardhjen e Jezusit. A flitet në këtë varg pikërisht për Jezusin apo për dikend tjetër. Të fillojmë me radhë:

1. Sot, me autoritetin e profetit Muhamed a.s. i cili është përgjegjës për sjelljen në jetë të një bashkësie të gjerë botërore, afro një miliard besimtarë besojnë:

- Lindjen e mrekullshesime të Isait - Jezusit

- Se Jezusi është Mesih

- Se ai me lejen e Zotit, i jepte jetë të vdekurit, shëronte etj. Pra muslimanët e pranojnë Jezusin (Isa a.s.) dhe Inxhillin.

2. Në anën tjetër të krishterët, përkundrazi e mohojnë të Dërguarin e Fundit - Muhamedin dhe besëlidhjen e Fundit - "kur'anin. Arsyeja e tyre është e thjeshtë: "Bibla nuk shkruan asgjë për Muhamedin". Sigurisht se ky libër (Bibla) përkundrazi faktit se gjatë shekujve ia ka nënshtruar falsifikimit, ka për të thënë diçka për Muhamedin. Për atë udhëheqës të madh të njerëzve, i cili fliste aq mirë për Jezusin dhe të ëmën e Tij Marinë (Merjemen).

3. Përgjegje mund të gjejmë në shkrimet Hebreje (Besëlidhja e vjetër) Në to (shkrimet Hebreje) ka me mijëra profeci të cilat u referohen profeteve që vijnë pas Mosheut 5 (Jojsiut, Musës a.s.) Si mund të themi që këto profeci i drejtohen Jezu Krishtit kur në asnjërin prej tyre Jezu nuk përmendet me emër.

Nomi i Dytë (Deuternany - ligji i përtëritë)

Kështu quhet libri i pestë i Mojsiut. Në kapitullin 18, vargjet 15 dhe 18 janë përfundimisht të njëjtë. Për të pasur një përkthim sa më konkret duhet të përdorim ndonjë nga përkthimet më të vjetra të Biblës.

"Do t'u dërgojmë atyre një profet nga mesi i vëllezërve të tyre, TË NGJASHËM ME TY (SI TI) dhe fjalët e Mia do t'i vendosi në gojën e Tij, kështu që ai do t'i flasë atyre çdo gjë që Unë e porosis. I cili njeri nuk do t'i dëgjonte fjalët e Mia, të cilat ai do t'i flasë në emrin Tim, Unë do të kërkojë prej Tij (përgjegjësi)" Ligji i përtëritës 18:18-19) DK.

Nga kjo kuptojmë se Perëndia, i premtoi Moisiut, se do të dërgojë një profet të ngjashëm me të (Moisiun). Kush është ky profet? Ky profet është i ngjashëm me Moisiun. Iftaret e Librit do të përgjigjen thjeshtë: Jezusi. Por të krishterët mund të sjellin vetëm dy ngjashmëri të Moisiut dhe të Jezusit:

1. Jezusi dhe Moisiu kanë qenë profetë, dhe
2. Mosiu dhe Jezusi kanë qenë hebrenj.

Në bazë të dy argumenteve të lartëpërmendura kjo profeci mund t'u referohet edhe Isasë, Ezekielit, Danielit, Joelit, Haseus, Zakariës, Gjon Pagëzorit sepse të gjithë këta kanë qenë profetë dhe hebrenj. Përkundrazi kjo profeci i drejtohet Muhammedit a.s. sepse Muhammedi është i ngjashëm me Moisiun. Këtë do ta vërtetojmë me disa argumente.

Argumentet e muslimanëve

1. Moisiu dhe Muhammedi kishin baba dhe nënë. Jezusi kishte vetëm nënë dhe nuk kishte asnjë baba njerëzor. Pra, Muhammedi është si Moisiu, e Jezusi jo.

2. Mosiu dhe Muhammedi lindën në mënyrë normale, me bashkimin fizik të femrës dhe mashkullit, mirëpo Jezusi u krijua përmes një mrekullie të veçantë.

"... është vërtetuar se ajo ishte me barrë nga shpirti i shenjtë" (Mateu 1:18) DK.

... kur dëshiron një send Ai vetëm i thotë atij: Bëhu! Ai menjëherë bëhet" Kur'an 19:35.

Pra, Muhammedi është si Moisiu e Jezusi jo.

3. Mosiu dhe Muhammedi u martuan dhe kishin fëmijë por Jezusi mbeti beqar tërë jetën. Pra, Muhammedi është si Moisiu e Jezusi jo.

4. Mosiu dhe Muhammedi u pranuan nga popujt e tyre si profetë gjatë tërë jetës së tyre. Jezusi nuk u pranoi si profet nga populli i tij, madje edhe sot hebrenjtë e refuzojnë Jezusin. "Erdhi në vendin e vet, por populli i vet nuk e pranoi" Gjoni 1:11 ECM. Pra, Muhammedi është si Mosiu e Jezusi jo.

5. Mosiu dhe Muhammedi bënë shpërnguljen. Moisiu u shpërngul prej Egjiptit në Sinaj, Muhammedi prej Mekës në Jethrib 6. Jezusi vetëm ndihëonte me apostujt e tij. Pra, Muhammedi është si Mosiu e Jezusi jo.

Vazhdojmë të lexojmë Ligjin e përtëritës (18:18):

"... fjalët e Mia do t'i vendosi në gojën e tij kështu që ai do t'u flasë atyre çdo gjë që unë e porosis" DK.

Me të vërtetë shpallja e Muhammedit është prej Zotit dhe Muhammedi a.s. e fliste çdo gjë që All-llahu xh.sh. e porosishte. "E s'ka dyshim se ti e pranon Kur'anin nga i Urti, i Dijshmi" "Kur'an 27:6

"Ne të dërguam ty me të vërtetën (Kur'anin), përgëzues dhe qortues, e ti nuk je përgjegjës për barmesit e xhelumitit" "Kur'an 2:119.

Prapë lexojmë Ligjin e përtëritës (18:19):

"E cili njeri nuk do të dëgjonte FJALËT E MIA, TË CILAT AI DO T'I FLASE NË EMRIN TIM, Unë do të

kërkoj prej tij (përgjegjësi)" DK. Me të vërtetë Muhammedi a.s. ka folur në emrin e Zotit. Shohim se çdo kapitull e Kur'anit (përveç El-Tevebe) fillohet me emrin e Zotit: BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIM e që do të thotë: NË EMËR TË ALLAHUT MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT". Pra, Muhammedi a.s. i plotësoi 3 kushtet e kësaj profecie. Iftaret e Librit nuk do të dorëzohen lehtë. Do të pyesim: "Pse Muhammedi nuk është çifut "si Moisiu" por është arab?

Profeti nuk është çifut

Përgjegjja gjendet mu në fillim të vargut 18 që e lexuam sipër: "Do t'u dërgojë atyre një profet NGA MESI I VËLLEZËRVE TË TYRE..." DK Me fjalën Vëllezërve të tyre, Bibla nënkupton Vëllezërit e hebrenjve. Kush janë "Vëllezërit e tyre".

Bibla flet se Abrahami kishte dy fëmijë: Ishmaelin dhe Jachakun 7. "Hagara i lindi Abramit një djalë dhe i vuri emrin Ishmael" Zanafilla 16:15. Por djali i madh i Abrahamit do të jetojë i udarë nga VËLLEZËRIT E TIJ. "Do të jetojë i veçantë nga gjithë fardësi i tij dhe do t'i provokojë" Zanafilla 16:12 ECM.

"...Me ata u realizua ajo që u tha për Ishmaelin, se ai do të jetonte i udarë nga VËLLEZËRIT E TIJ dhe do t'i provokonte ata". Zanafilla 25:18 ECM. Mosiu dhe hebrenjtë njëriin nga Jachaku, ndërsa Profeti i ngjashëm me Moisiun (që u argumentua me lart) Muhammedi a.s. njëri nga "MESI I VËLLEZËRVE TË TYRE", pra nga pasardhësit e Ishmaelit. Nga kjo shohim se Muhammedi e plotësoi edhe kushtin e katërt të kësaj profecie. Dhe ata që nuk e besojnë këtë profet: "Unë do të kërkoj prej tyre (përgjegjësi)" Ligji i përtëritës 18:19 DK. Si pra të krishterët dhe jehudët nuk e besojnë Muhammedin a.s. dhe Kur'anin kur Zoti prej tyre do të kërkojë përgjegjësi për këtë?

A je ti Profeti i pritur?

Tani do të lexojmë një tregim interesant në Ungjillin e Gjoni. Është tregimi për Gjon Pagëztorin (Huzreti Jahjau a.s) Derisa ishte duke i pagëzuar njerëzit me ujë erdhën disa priftërinj dhe levit dhe e pyetën: "...Kush je ti? Gjoni nuk iu shmanng pyetjes, por u tha haptazi: "Unë nuk jam Mesia shpëtimtari i premtuar. Kush je ti pra? - me pyetën ata. A je Elija? Jo, as Elija nuk jam - u përgjigj Gjoni. A je ti PROFETI I PRITUR? - pyetën. Jo u përgjigj. "Gjoni" 1:19-21 ECM. Pra, Gjon Pagëztori u përgjigj se nuk është as:

1. Mesia-shpëtimtari i premtuar (Jezu Krishti)
2. Elija-një profet që pritej të vijë
3. PROFETI I PRITUR

Kush është Profeti i PRITUR/ Cilin Profet e pritnin çifutët përveç Mesisë dhe Elisë? Çifutët e pritnin PROFETIN SI MOISIUN, që do të vijë NGA MESI I VËLLEZËRVE TË TYRE e që e argumentuam se ai është Muhammedi a.s.

KAPITULLI I DYTË

A ËSHTË BIBLA FJALË E ZOTIT

Komentit i gabuar i ihtarëve të Librit

Nën titullin "Ta identifikojmë Librin e së Vërtetës" autorët 8 e "Koha për nënshkrimin..." tregojnë se çka thotë Kur'an për tri librat e shenjta para tij: Teuratën (Torah-

Ligji-Pesë libërzan), Zeburin (Psalmet e Davidit) dhe Inxhillin (Ungjillin). Autorët e teprojnë shumë kur thonë se: "Kur'anit saktëson me rreptësi se nuk mjafton vetëm të dish se cilat Libra janë fjale të Perëndisë. Duhet edhe t'i zbatojnë atë që thonë këto libra".

Në Kur'an nuk ka ndonjë ajet që i obligon muslimanët të punojnë me Tevrat. Megjithatë autorët e gjejnë shpëtimin: "Shembulli i atyre, që janë obliguar me Tevrat dhe nuk e zbatojnë atë, është si shembulli i ndonjë gomari që bartin libra9..." Këtu nuk është fare fjala për muslimanët. Fjala është për jehuditë. Ata ishin të obliguar me Tevrat por nuk i përmbaheshin atij. Ata 9jehuditë në Tevrat lexuan për ardhjen e profetit Muhammed por kur erdhi ai, ata nuk e pranuan.

Mund të thotë dikush: Pasi jehuditë në këtë ajet nuk janë përmendur me emër, atëherë ky ajet mund t'ia drejtohet muslimanëve e jo jehuditë? Nese e lexojmë me kujdes Kur'anin (Sureja 62 El-Xhuma) shohim se tërë kjo pjesë e Kur'anit (Ajetet 5-8) u drejtohet jehuditë. Hapeni Kur'anin dhe vërtetoni.

Autorët sjellin edhe një ajet tjetër Sureja El Maide 68: "Thuaj: O ithtarë të librit, ju nuk jeni asgjë (ne fe) derisa të të mos e zbatoni Tevratin, Inxhillin dhe atë që ju zbriti nga Zoti juaj..." Nuk e di përse autorët e marrin këtë ajet. Ky ajet fare nuk i obligon muslimanët t'i përmbahen Tevratit dhe Inxhillit. Fjala: "EHLUL KITAB (Ithtarët e librit)" në Kur'an përdoret për jehuditë dhe të krishterët.

Besimi në librat e Zotit

Kjo është shtylla e tretë e fesë Islame. Kur'anit na mëson se All-lahu xh.sh. u ka shpallur librat e veta edhe pejgamberëve para Muhammedit a.s. Ne jemi të informuar për fletushkat e Ibrahimit, por edhe për tri librat e mëdha: Tevrat (Ligji-Tarahu) i Musaut, Zeburi i Davvudit (psalmet) dhe Inxhili i Isaut a.s. Për librat e pejgamberëve të tjerë Kur'anit nuk na jep ndonjë informata. Fletushkat (Suhufet) e Ibrahimit humbën dhe nuk kanë lënë kurrfarë gjurmë në literaturën botërore. Tre librat tjerë ekzistojnë te hebrenjtë dhe të krishterët, por Kur'anit na mëson se njerëzit i kanë ndryshuar këto libra. Në Bibël, Tevrat është i përmblodhur në pesë libra: Zanafilla (gjeneza), Dalja, Kodi priftëror, Regjistrimet (Numrat) dhe Ligji i përtëritë. Këto libra nuk e përbëjnë Tevratin origjinal, por janë vetëm fragmente të Tevratit të përziera me rëfime të njerëzve. Në gjendje të njëjtë janë edhe Psalmet (Zeburi). Më së keqi ka kapërcyer Inxhili i Isait. Në Bibël ekzistojnë katër Unxhij të cilët në realitet nuk janë Inxhili origjinal por janë "Biografia e Isait" të shkruara nga katër njerëz të ndryshëm në bazë të njohjes së tyre dhe thashethënëve të dëshmitarëve tjerë.

Vet "Ithtarët e Librit" pranojnë se nuk i kanë origjinalet e Librit të Zotit, por vetëm përkthimet të cilat me shokuj kanë përjetuar shumë ndërrime. Fjalët e Zotit dhe të njeriut janë të përziera në këtë libër, sa që vështirë është të klasifikojmë se çka rrjedh prej Zotit e çka prej njeriut.

Duke i studiuar këto libra, gjejmë fragmente dhe përshkrime të ndryshme që kanë të bëjnë me mohimin e cilësive të All-lahut, shpifje pejgamberëve, tregime amorale, kundërtënie etj.

Dhjata e Vjetër

Të shikojmë se në çfare gjendje janë Libërzanat e Tevntit. Lexojmë pak nga Zanafilla - Libri i parë i Mojsint.

Këtu është tregimi për Adamin dhe Evën të cilët pasi e hëngrën pemën e ndaluar lëvuan dituri dhe e kaptuan se ishin lakuriq: "Atë mbrëmje kur u freskua, ata dëgjuan Zotin që po kalonte përmes kopshtit U fshihen midis pemëve, por Perëndia e thirri njeriun dhe i tha: Ku je?" Zanafilla 3:8-9 ECM. "Icure ironie? Këtu thuhet se Zoti nuk e paska ditur se ku janë Adami dhe Eva por paska pasur nevojë të thërrasë: "Ku je?" Këtu mohohet cilësia e Allahut "ILM" Zoti di gjithçka. Kjo cilësi pranohet nga të gjitha fetë të cilat janë në Tokë, por autori i Zanafilës e mohon këtë. I lartësuar gofë All-lahu nga kjo që ia mveshin. Në të njëjtin libër ka edhe shumë thënie të ngjashme me të parën, kur mohohen cilësitë e All-lahut: "Zoti zhiu për të parë qytetin dhe kullën që kishin ndërtuar njerëzit" (Zanafilla 11:5 ECM). "Pastaj Zoti i tha Abrahamit: Ka padi të tmerishme kundër Sodomes e Amores. Mëkati i tyre është shumë i madh. Unë duhet të zbres atje që të marr vesh nëse padit që kam dëgjuar janë të vërteta (Zanafilla 18-20 ECM).

"Rrugës për në Egjipt, pranë një pushimi, Zoti e takoi Masheun dhe kërkoi ta vriste. Atëherë Lipura, gruaja e tij, meri një gur të mprehtë, i preu kafshin të birit dhe me të ia preku organet gjenitale Masheut. Për shkak të rritit të rrethprejës ajo i tha Masheut: Ti je për mua burrë gjaku. Kështu, Zoti ia fali jetën Masheut" (Dalja 4:24-26 ECM).

Këto tregime qesharake nuk i përkasin librit origjinal të Zotit por ndonjë romani apo komedie. Në Bibël gjithashtu hasim në shpifje kundër pejgamberëve:

- Thuhet se Luti a.s. (loti) ka bërë prostitucion me bijat e veta (Zanafilla 19:30-37)

- Se Davvudi e dërgon Urjen në luftë me qëllim që të vritet, e Davvudi të marrë gruan e tij (2 samueli 11:1-26).

- Se Sylejmani a.s. është mashtruar me idhujtari (1 Mrestërit 11:1-13) etj. Gjithashtu në Bibël ka edhe rëfime të pamoralshme siç është në Zanafilla 38:1-18. Hapeni Biblen tuaj dhe do të vërtetoheni vetë.

Shkurtesat:

Dk. përkthimi Daniqig - Karashiq i Biblës, po vit botimi Zagreb

ECM - përkthimi ECM në gjuhën shqipe 1993

GBV - Dhjata e Re dhe pasallimet - 1991

1. Ithtarë të Librit EHLUL KITAB në Kur'an qthën Jehuditë dhe të krishterët
2. "Koha për shtundrimin e vërtetë ndaj Perëndisë fq. 9
3. Thërris "jehovist" sepse përkthimi "Bota e re është përkthyer dhe botuar nga organizatat e Dëshmitarëve të Jehovait
4. Draku do të thotë parajjmësim për një ngjarje që do të ndodh në këtë rast parajjmësim Muhammedin a.s.
5. Ky term përdoret në përkthimin ECM
6. Dëshitë qthëj para hijshetit - Mëdha e sonare
7. Insuli dhe Is-laku
8. Kemi përdorur termin anëtarët sepse zakonisht "dëshmitarët e Jehovait" pranojnë në grup.
9. El-Xhumra 5

Lulëzim Blaka Hla

LETRAT E LEXUESVE

Edhe kësaj radhe në redaksinë tonë kanë arritur shumë letra përshëndetëse. Ndër to veçuan: Flamur Kamberi nga Podujeva, Shefki Berisha nga Mitrovica dhe Muhamet Isufi nga Gillogovci, të cilët na përshëndesin përzemërsisht, duke na uruar punë të mbarë dhe suksese të mëtejme. Njëheri shprehin dëshirë që të bashkëpunojnë me ne.

Të gjithë lexuesit i falënderojmë për letrat dhe përshëndetjet e tyre duke shprehur dëshirë që bashkëpunimi të vashdoi edhe më tej. Gjithashtu ju dëshirojmë suksese në mësim dhe lanturi në jetë, duke ju përshëndetur me përshëndetjen islame, përshëndetje shumë e begatshme dhe e bukur nga Allahu xh.sh. Es-selamu alejkum.

NE PYESIM JU PËRGJIGJUNI!

Lexues të nderuar, edhe kësaj radhe mirëkujtoni, ka zgjuar kureshtjen për njohuri të reja mbi islamit. Si edhe terave tjera, ashtu edhe në këtë numër, ka arritur një numër i konsiderueshëm i letrave tuaja, me përgjigje tona. Loja jonë shprehlyese ka edhe fituesit e sajë, të cilët në pyetjet e parashtruara dhënë përgjigje korrekte. Kësaj radhe veçuan:

Labiriot Asllani, nga Pusthë Kosova, Faruk Beqiri nga Viti, dhe Qerim Hundozi nga Rahoveci. Të gjithë ata që nuk paten fat kësaj radhe, ju dëshirojmë pjesmarje të suksesshme në të ardhmen.

Përgjigjet e pyetjeve nga numri kaluar janë:

1. *Katër halifet (prerë) e parë të muslimanëve pas Muhamedit a.s. ishin: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r.a.*

2. *Ajo e parë të Dërguarit a.s. iu shpallë në shpellën Hira.*

3. *Kalendari e muslimanëve e formoi Omeri Ibën Hatabi dhe u bazua në hijetarin e Muhamedit a.s.*

4. *Simpoziumi ndërkombëtarë me temën "Faqe, tradita dhe kultura Islame ndër Shqiptarët" u mbajt në 15. shtator, 1992, në lokalit e Medresesë së Mevne "Aluddin" në Prishtinë.*

Ndërsa pyetjet për këtë numër janë:

1. *Në cilin vit e bëri Pejgamberi hijshretin?*

2. *Në cilin vit sipas Hijshretit është bërë obligim agjërimi?*

3. *Në cilin muaj filloi të zbres Kur'ani?*

4. *Cila është xhamia e parë që është ndërtuar në kohën e Muhamedit a.s.*

Mbesim me shpresë se nuk do të kenë vështirësi të përgjigjeve në pyetje tona.

KOSOVA SPROVE MBI SPROVË

Kosova është unazë,

që secili mundohet

ta ketë në gishtin,

që deri tani askujt

nuk i ka takuar.

Kosova është unazë,

jo magjike e as e arit,

por unazë që përthekon

jetën e shqiptarit.

Kosovë nënë Kosovë,

në errësirë jeta të shkoj,

dritë az diell për ty nuk ndriti,

dritë e bardhë nuk agoi.

Nga nëna armiqe të ndanë,

e në errësirë të lanë,

shunë sprova të bënë,

Kosovë e imja Kosovë.

Blerim Tërnuca kl. Idr.

A E DINI SE/

1. Halifi i tretë h.Othmani r.a. në një rust në hutbe i foli vetëm këta dy fjale: El-Hamdulil-lah (Falenderimi i qofë Allahut), pastaj zbriti dhe me as-habet i fali dy rekate namaz të xhumasë. Askush nuk tha asgjë. Me siguri kjo ishte hutbeja më e shkurtër në histori.

2. Ndër shumë peshoja të sakta, me e sakta në botë është peshoja "Sartours" në Göttingen (Gjermani). Kjo peshojë mund të matë objekte edhe me peshë prej 0.5 gramesh, madje me një saktësi prej 0.00000001 gramesh, e kjo është një peshë që 60 herë është më e lehtë se pesha e ngjyres që duhet shpenzuar për të shtypur pikën në mbarim të fjalisë.

3. Ora më e jashtëzakonshme në botë gjendet në muzeun e qytetit sovjetik Saratov. Ajo orë është prodhuar në Francë, ka më se 95 fytyra numërore dhe 25 susta për kundisje. Ora më e çuditshme tregon njëkohësisht sa është ora në të gjitha viset e botës, tregon edhe ditën, muajin dhe vitin, madje sipas kalendarit Grekorian, Musliman dhe kalendarit Çifut.

4. Vendimi më i çuditshëm konsiderohet vendimi që e ka nënshkruar në vitin 1568 mbreti spanjoll Filipi II e me të cilin janë dënuar me vdekje 3 milion bunorë të Holandës. Por për fat ai dënim nuk është ekzekutuar kurrë, prandaj ka mbetur vetëm si një dokument qesharak i të kaluarës.

5. Ebu Muhamed, dijetar nga Andaluzia (Spanja) thotë:

Në qytetin Hims, ka jetuar një grua e ndershme e cila në lindjen e parë lindi një femijë, kurse në lindjen e dytë lindi dy femijë, në lindjen e tretë tre femijë, në të katërtën - katër, në të pestën - pesë...

H u m o r

Pena e Naimit

- Babi, sa të madhe e ka pasur penën Naim Frashëri?
- Penë e zakonshme. Ç'është kjo pyetje?
- Është mësuari më i madh se ka luftuar me penë për mëndjen.

Shokët më ngacmohjet

- DJALI: Babi, shokët më ngacmojnë që ne kemi shtriptë të bukur, veturë...

- BABAI: të thonë: djale kapitalisti?

- DJALI: jo, djale hajde.

Vetëm fletën e bardhë

- Mësuari u dha si detyrë nxënësve të shkronjave në shëpti një hartim me temë "Derabelizimi".

- Bardhi ja paraqiti mësuarit vetë fletën e bardhë pa shkruar asgjë.

- Çka do të thotë kjo? - e pyeti i habitur mësuari.

- Detyrë e shëptit, - u përgjigj Bardhi.

Këmba

- Arsantarija u shpëgoi nxënësve se si i ka shërbyer natyra me ndonjë virtut, të gjithë ata që kanë ndonjë shqisë marigut. Për shembull, - vazhdon ajo, - të verbërit, e kanë të zhvilluar shqisën e të njuhaturit, të shurdhërit, shohin më mirë se njerëzit e rëndomtë, etj. - Edhe ndonjë shembull të ngjashëm? - pyeti ajo më në fund.

- Unë, - ngriti gishtin Luani.

- Thuaje, - i dha leje arsanitarija.

- Për shembull, - vazhdon Luani, - të gjithë ata që e kanë njërin këmbë më të shkurtër, qetësohen e kanë më të gjatë.

Fjalëkryqi klasik

HORIZONTALISHT: 1. Fjeta - më mori... - Mbiemri i autorit të këtij fjalëkryqi 2. Emri i perandorit bizantin në shek. VII. - emri i Ademut a.s. në bibël. Inksioni që u jepet fëmijëve të posalindur - emri i përmendurës së dëshmorëve të panjohur në Beograd. 4. Bën, shtrish punë - mëkat (anglisht) - Manafortra (shkrutimisht) 5. Laminë, tencoc (anglisht) - toka e punuar - Axhami, fëmijë 6. Enver Tahiri (Nistoret) - Zanorja e I - zanorja e IV. 7. Popull në spanjë - ilaqi, lapi (i pashquar) - krijesa tjetër përpos njerëzve dhe ëngjëjve - bashkëtingëlloja e I. 8. Estonez (gjinia femërore) - Pjata, sahani - një zanore. 9. Det, oqean (Anglisht) - gjykim (arabisht) - Prisi i O.Q e Vales. - Arafati. 10. Shkronja e 28 e alfabetit tonë - lute, Adhurim - vrimat - zanorja e 4.

VERTIKALISHT: 1. Shkronja e 12 e alfabetit tonë. 2. Emri i autorit - në imiri (anglisht). 3. Element kimik - kampione. 4. Vegël për të punuar - ylli (anglisht). 5. Numër i panjohur - emri i monedhës evropiane. 6. Druritë e gjatë - termi, mbetmje. 7. I bukur - pëlluar. 8. Një bashkëtingëllore - industria e naftës Aman (nistoret) - gjykim (arabisht) 9. Radiume - gadishulli ku u shpall Kur'an. 10. Emri i Ademut a.s. në bibël - një bashkëtingëllore. 11. Havari (Gjinia femërore - i shquar). 12. Besimi (arabisht) - smira. 13. Gruri i Bluar - Naser (shkrutimisht). 14. Një zanore - shkronja A - një zanore. 15. Një bashkëtingëllore dhe një zanore.

Përgatiti:

Xheva Brahim Kl IV-a

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	G	U	M	I				B	R	A	H	I	M	I	
2	H	E	R	A	K	L	I		A	D	A	M	I		
3	V	A	K	S	I	N	I			A	V	A	L	L	A
4	A	N	I		S		N			M	A	N			
5	T	I	M		A	R	A			I	R	I			
6				E	T			A			I				
7	B		S	K			B	A	R		X	H	I	N	
8	E	S	T	U	N	E	Z	E			E	N	A		
9	S	E	A		A	Z	A	B			J	A	S	E	R
10	T		R	U	A		B	I	R	A	T				I